



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

# **RAPORT**

**PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE  
TË TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT**

**“Agjencia e Prokurimit Publik”**



**Tiranë, dhjetor 2018**



**RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI**  
**AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË AGJENCINË E**  
**PROKURIMIT PUBLIK**

**Titulli:** “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit ”

**Subjekti:** “Agjencia e Prokurimit Publik”

**Përgatitur:** 07 dhjetor 2018

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 865/2, datë 11/09/2018.

Auditimi është kryer nga:

1. Kozma Kondakçiu, përgjegjës grupi
2. Elira Cukalla, anëtar
3. Bledi Dervishaj, anëtar

Periudha e Auditimit: 01.01.2017 – 30.06.2018

Afati i auditimit: 03.09.2018 – 08.10.2018



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**PËRMBAJTJA:**

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3
	<b>a</b> Përshkrimi i Projektit të Auditimit	3
	<b>b</b> Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi	4
	<b>c</b> Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.	6
<b>II.</b>	<b>HYRJE</b>	6
	<b>a</b> Objektivat dhe qëllimi	6
	<b>b</b> Identifikimi i çështjes	7
	<b>c</b> Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7
	<b>d</b> Përgjegjësitë e audituesve	8
	<b>e</b> Kriteret e vlerësimit	8
	<b>f</b> Standardet e auditimit	9
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	9
<b>IV</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	11
	<b>1</b> Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	
	Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK	11
	Vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik	15
	<b>b</b> Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK	32
	<b>2</b> Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit	36
	<b>a</b> Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK	36
	<b>3</b> Auditimi i Sigurisë së Informacionit	43
	<b>a</b> Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK	43
	<b>4</b> Auditimi i Aplikacioneve	46
	<b>a</b> Verifikimi i shkallës së sigurisë së aplikacioneve	46
	<b>5</b> Të ndryshme të dala gjatë auditimit	57
<b>IV.1</b>	<b>REKOMANDIMEVE PËR PËRMIRËSIME</b>	60
<b>V</b>	<b>DOKUMENTACIONI SHOQËRUES</b>	68
<b>VI</b>	<b>Tabela e shkurtimeve.</b>	70



## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **I.a. Përshkrimi i Projektit të Auditimit**

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Agjencisë së Prokurimit Publik, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë rrisht, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e APP-së, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron, administrimit të procedurave të prokurimit elektronik si dhe nxjerrjen e akteve rregullatore mbi këto procedura.

Në opinionet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë auditimit janë mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, si më poshtë:

- Mandati për kryerjen e Auditimit mbështetet në ISSAI 1 Neni 22 dhe Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14.
- Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA)<sup>1</sup> Gjatë këtij auditimi u përdor Manuali Aktiv i TI i cili u zhvillua gjatë it të binjakëzimit në KLSH dhe kishte objektiv thelbësor vënie në praktikë të "Manualit WGITA - IDI mbi Auditimin e TI-së për Institucionet Supreme të Auditimit".
- COBIT 4.1 Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit.<sup>2</sup>
- Udhëzime mbi Auditimet Teknologjinë e Informacionit, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23.<sup>3</sup>
- ISSAI 100.36,48 Udhëzime për të gjitha auditimet e sektorit publik<sup>4</sup>.
- ISSAI 5310 - udhëzues për shqyrtimin e sigurisë së sistemit të informacionit (ISS) në organizatat qeveritare.

Mbështetur për sa më lart janë mbajtur aktet përkatëse të auditimit, janë shqyrtuar observacionet të cilat gjenden të reflektuara në këtë raport, gjithashtu kemi propozuar rekomandimet përkatëse.

Në përfundim të këtij auditimi, KLSH do sigurojë palët e interesit si dhe gjithë përdoruesit e sistemit elektronik të APP, nëse ky sistem ka arritur qëllimin kryesor, atë të lehtësimit të kryerjes së procedurave të prokurimit, sigurimin e konfidencialitetit së të dhënave, si dhe rritjen e ekonomicitetit në shpenzimet e institucioneve publike nëpërmjet zhvillimit të procedurave elektronike të prokurimit publik.

<sup>1</sup> <http://www.intosaiitaudit.org/WGITA23rd/23rdWGITAMeeting/Arabic%20IT%20Audit%20Handbook.pdf>:

<sup>2</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Manual\\_i\\_Auditimit\\_te\\_Teknologjise\\_se\\_Informacionit\\_1488\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Manual_i_Auditimit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1488_1.php)

<sup>3</sup> [http://www.klsh.org.al/web/COBIT\\_4\\_1\\_Objektivat\\_e\\_Kontrollit\\_te\\_Teknologjise\\_se\\_Informacionit\\_1555\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/COBIT_4_1_Objektivat_e_Kontrollit_te_Teknologjise_se_Informacionit_1555_1.php)

<sup>4</sup> <http://www.issai.org/data/files/75/61/65/99/F5DF8510F72E9F859B59F9C2/issai-5300-e-exposure-draft.pdf>

<sup>4</sup> [http://www.klsh.org.al/web/Standardet\\_Nderkombetare\\_te\\_Auditimit\\_ISSAI\\_1\\_400\\_1867\\_1.php](http://www.klsh.org.al/web/Standardet_Nderkombetare_te_Auditimit_ISSAI_1_400_1867_1.php)



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**I.b Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi.**

**1. Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit,

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi strategjinë e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se nuk ekziston një strategji IT, por ka elemente të dokumentuar të saj si plane mbi IT dhe proceset për zhvillimin, aprovim, zbatimin dhe mirëmbajtje të IT.

**Ndikimi/efekti:** Mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumentave të nevojshëm për matjen e objektivave, keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së APP.

**Shkaku:** Mos zbatim i praktikave më të mira në këtë fushë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të APP, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

**2. Titulli i gjetjes** App nuk ka menaxhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave IT.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se: App nuk ka menaxhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave IT në përputhje me Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr, prot 3285 datë 19.03.2018 duke mos udatuar ndryshimet në rregulloret, ndarjen e detyrave të njësisë së Teknologjinë e Informacionit në përputhje me organizimin, strukturën e re.

**Ndikimi/efekti:** Mos menazhimi i ndryshimeve në burimet njerëzore të IT mbart riskun e mos plotësimit të detyrave të kësaj strukture në përputhje me objektivat institucionale.

**Shkaku:** Mos menazhim i ndryshimeve.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi:** APP në të ardhmen të marrë masa për rishikimin e bazës rregullative të strukturave IT në APP në përputhje me çdo ndryshim strukturor të kryer.

**3. Titulli i gjetjes** Me ndryshimet e strukturave IT, APP-së i cënohet pjesa e rëndësishme e Qeverisjes IT. Roli i strukturës IT nuk duhet dhe mund të zëvendësohet me struktura të tjera pasi struktura IT luan një rol të rëndësishëm në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarrjes në vendimarrje për problemet e IT.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se: APP pas daljes së VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 sipas së cilës strukturat IT kalojnë në varësi nga AKSHI-t (të APP-së dhe jo vetëm ) ndërmer ndryshime të strukturës IT me Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë së prokurimit Publik nr, prot 3285 date 19.03.2018.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Për sa më sipër APP i drejtohet DAP për propozimin e transferimit të përhershëm të nënpunësve civile në kuadër të ristrukturimit i kërkon transferimin e përhershëm të drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së informacionit dhe publikimit si dhe 7 specialistëve, të APP nga Drejtoria, e Informacionit dhe Publikimit në Drejtorinë e Informacionit dhe Publikimit.

**Ndikimi/efekti:** Ulje të rolit IT-së si mjet i rëndësishëm për menaxhimin e lartë për përmbushjen e misionit të APP.

**Shkaku:** VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 (kalimi i strukturave IT në varësi nga AKSHI-t)

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim për përmirësim Ligjor :** Kërkimit KM ndryshimin e VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 pika 23.

**Ishte:** Strukturat përgjegjëse së AKSHI-t, Punonjësit aktuale të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit(NJTIK) në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave , kalojnë tek AKSHI, brenda datës 31.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënpunësit civil në rastin e mbylljes së ristrukturimit të institucionit , apo Kodt të Punës AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i” të pikës 6 personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fushat e veprimit të këtij vendimi (kalimi i strukturave IT në varësi nga AKSHI-t)

**Shtohet:** *Në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, ngelet/krijohen strukturave IT në varësi direkte nga menaxhimi i lartë i institucioneve përkatëse me funksion kryerjen e detyrave të qeverisjes IT.*

#### **4. Titulli i gjetjes:** Pozicioni Officer Sigurie

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se pozicioni i kërkuar për Officer Sigurie nga APP nuk është miratuar në strukturën e saj gjatë periudhës objekt auditimi. APP nuk disponon as ndonjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë e cila ka qenë një rekomandim nga KLSH në auditimin e mëprashëm.

**Ndikimi/efekti:**

**Shkaku:** Officer i Sigurisë është një pozicion i pa njohur në Institucionet shtetërore.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** APP nën përgjegjësinë që i jep ligji për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave të prokurimit publik, të rikërkojë ndryshim të strukturës për pozicionin Officer Sigurie i cili edhe pse formimin mund ta ketë të bazuar në Teknologjinë e Informacionit nuk është pjesë e strukturës së TIK, por raportimi i tij duhet jetë në nivelin më të lartë drejtues të APP bazuar në standartet ndërkombëtare, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia dhe mund të shmangët konflikti i interesit, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**I.c Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.**

Grupi i auditimit mbështetur në Standartet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH " datë 27.11.2014 konstaton:

- Agjencia e Prokurimit Publik, ka marrë masa rregullative dhe organizative, për të garantuar disponibilitetin e sistemeve të informacionit, masat e marra për rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procedurave të prokurimit kanë rezultuar të suksesshme duke frenuar përdorimin e procedurës së prokurimit “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” gjatë vitit 2018 në krahasim me treguesit e vitit 2017.
- Ndryshimet e strukturave të IT në APP (dhe jo vetëm) mbartin riskun e dobësimit të Qeverisjes IT duke ulur rolin e tyre në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarrjes në vendimarrje.
- Rezultatet e aritura janë të kompromentuara nga mungesa e Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit, duke mbartur riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së APP.

**II. HYRJE**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 865/2, datë 11.09.2018 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.09.2018 deri në datë 08.10.2018, në Agjencinë së Prokurimit Publik, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 30.06.2018, u krye auditimi mbi “Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, nga Grupi i Auditimit i përbërë nga:

1. Kozma Kondakçiu, Përgjegjës Grupi
2. Elira Cukalla, Audituese e Lartë
3. Bledi Dervishaj, Auditues i Parë

**a. Objektivat dhe qëllimi:**

*Objekti i Auditimit TIK* ushtruar në APP, është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet TIK, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

*Qëllimi i Auditimit TIK*, është dhënia e opinionit apo vlerësimi nëse menaxhimi i lartë drejton, vlerëson dhe monitoron në mënyrë efektive kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve TIK dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Vlerësimin nëse të dhënat janë të sigurta kundrejt keqpërdorimeve.

Objektivat e këtij projekt auditimi, u vendosën në koherencë me veprimtarinë, vizionin, qëllimin dhe objektivat e APP, duke marrë në konsideratë të gjithë kuadrin rregullativ në bazë të të cilit APP zhvillon veprimtarinë e saj. Për të arritur në dhënien e një opinionit me një siguri të



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

arsyeshme, është mbledhur informacion, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse ky sistem mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive dhe përdor burimet në mënyrë efëçente.

**b. Identifikimi i çështjeve:**

Nisur nga rëndësia e të dhënave të Agjencisë së Prokurimit Publik si dhe funksionaliteti i APP nëpërmjet teknologjisë me qëllim garantimin dhe vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimit online, fokusi i auditimit ishte në:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK
  - a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK, vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik
  - b. Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK
2. Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit
  - a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK
3. Auditimi i Sigurisë së Informacionit
  - a. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK
4. Auditimi i Aplikacioneve
  - a. Verifikimi i shkallës së sigurisë së aplikacioneve

**c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Agjencia e Prokurimit Publik, bazuar në ligjin nr. 9643 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kryesisht ka përgjegjësi për:

-Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave Standarte të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

-Verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;

-Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;

-Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;

-Përfshirjen e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;

-Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

#### **d. Përgjegjësitë e audituesve:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi APP, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2017 deri në 30.06.2018, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK. Nga Grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 865/2, datë 11.09.2018, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, Grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon APP. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

#### **e. Kriteret e vlerësimit:**

Vlerësimi në lidhje me konkluzionet është bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet e përcaktuara nga AKSHI, si dhe praktikat më të mira mbështetur në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit, si më poshtë:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij, Ligjet për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe aktet ligjore në zbatim të tij, Legjislacioni mbi Krimin Kibernetik;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 10 325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”,
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”,
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit,
- Udhëzimi nr. 1159 datë 17.03.2014, i ndryshuar “Për hartimin e marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar,
- Standardet TIK
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**f. Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknika auditimi, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

Duke filluar nga janari i vitit 2007 është punuar për Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) si pjesë e nismës për qeverisjen elektronike në Shqipëri të mbështetura nga Marreveshja dy vjeçare Prag e Sfides së Mijëvjeçarit për Shqipërinë ndërmjet Qeverisë shqiptare dhe Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit ([www.mcc.gov](http://www.mcc.gov)), nën administrimin e USAID-it.

Me anë të VKM Nr. 659 datë 3.10.2007 “Për rregullat e kryerjes se procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”, është miratuar përdorimi i sistemit elektronik në prokurim, për të kryer të gjitha procedurat e prokurimit, të parashikuara në LPP. Këtu përfshihen si kryerja e procedurës vetëm përmes rrugëve elektronike dhe ajo e ndërthurjes së formës elektronike me atë shkresore, për disa lloj procedurash, që e kërkojnë këtë.

**Data e vënies në shërbim**

- Duke filluar nga data 4 dhjetor 2007, Qeveria Shqiptare ka miratuar zyrtarisht përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) pas pilotimit të suksesshëm të tij nga Korporata Energjetike Shqiptare (KESH) në prokurimin me vlerë 220 milion euro për blerjen e furnizimit vjetor me energji elektrike.
- Gjatë vitit 2008 të gjitha organet qendrore kanë aplikuar prokurim elektronik dhe më pas me anë të VKM Nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronike” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 22 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Per prokurimin publik”, të ndryshuar, të gjitha procedurat e prokurimit të zhvillohen me anë të sistemit të prokurimit elektronik (SPE).
- Gjatë vitit 2013, pjesë e sistemit të prokurimit elektronik (SPE) u bënë edhe prokurimet me vlerë të vogël me anë Vendimit Nr. 47 Datë 23.01.2013 “Për një shtesë në vendimin nr. 45 datë 21.01.2009 të Këshillit të Ministrave për kryerjen e procedurave në mënyrë elektronik”, të ndryshuar.
- Gjatë vitit 2017, me VKM Nr. 796, datë 29.12.2017 “Për një ndryshim në VKM Nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, është sanksionuar detyrimi që edhe procedura e prokurimit “Me negociim pa shpallje paraprake” të zhvillohet nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Pra, aktualisht zhvillohen nëpërmjet SPE procedurat e mëposhtme:

- procedurë e hapur;
- procedurë e kufizuar;
- procedurë me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

- procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
- kërkesë për propozime;
- konkurs projektimi;
- procedurë “shërbim konsulence”;
- procedurë prokurimi me vlerë të vogël.

Përfshihen nga zhvillimi nëpërmjet SPE procedurat e mëposhtme:

Mallrat dhe shërbimet për të njëjtin zë gjatë gjithë vitit, me vlerë deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë, për të cilat, autoriteti kontraktor nuk do kryejë procedura prokurimi, por do të procedojë direkt me blerjen e mallit dhe shërbimit, kundrejt faturës;

Blerja e mallrave apo për kryerja e shërbimeve nga autoriteti kontraktor, vlera e përlogaritur e të cilave gjatë gjithë vitit kalendarik është në kufijtë e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël (me e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë, por më e vogël se 800.000 (tetëqind mijë) lekë), në rast të krijimit të situatës emergjente;

Faza e dytë e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence” dhe “Konkurs projektimi”;

Procedurat e prokurimit me objekt “Blerja e energjisë elektrike”.

Gjatë vitit 2016, në kuadër të zhvillimit të grantit konkuroes “Shqipëria Digitale”, financuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), Agjencia e Prokurimit Publik (APP) aplikoi duke paraqitur projektin për infrastrukturën e re të Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe Arkivës Elektronike.

APP arriti të nënshkruante kontratën me Nr. 8812 Prot., datë 14.07.2016, me objekt “*Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve / shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re*”.

Sipas kësaj kontrate, afati për implementimin e projektit ka filluar me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët kontraktuese dhe ka përfunduar në datë 07.04.2017, dhe më pas nga momenti i mbarimit të implementimit të projektit, ka filluar zëri Nr. 5 “Mirëmbajtje” në tabelën e shërbimeve, afati i të cilit është 2 (dy) vite kalendarikë.


Duke qenë se sistemi është ndërtuar gjatë vitit 2007, teknologjitë e përdorura i përkasin asaj kohe ose pak me herët.

*Struktura organizative e Agjencisë Prokurimit Publik*



# KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

## RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).



### IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Në zbatim të programit të auditimit nr. 865/2, datë 11.09.2018, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe pas ndarjes së detyrave për secilin anëtar të Grupit të auditimit, miratuar nga Drejtori i Drejtorisë, nga Grupi i auditimit, u audituan pikat e programit, si më poshtë:

#### Pika 1. “Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK”

*a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK, vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik.*

*Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK*

#### **Objektivat e Auditimit:**

- Konfirmimi nëse ekziston një strategji IT, e cila përfshin plan IT dhe proceset për zhvillimin, aprovimin, dhe zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë, e cila është e lidhur me strategjinë dhe objektivat e organizatës. Risqet dhe burimet gjatë përbushjes së objektivave të IT janë të menaxhuara efektivisht.
- Vlerësimin nëse menaxhimi i APP drejton, vlerëson dhe monitoron efektivisht përdorimin e IT, me qëllim përbushjen e misionit.
- Garantimi se ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat që mundësojnë organizatën të arrijë mandatin për qëllimet e biznesit.

#### **Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Agjencia e Prokurimit Publik është organ qendror, person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që financohet nga Buxheti i Shtetit.

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin Nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat” dhe Ligjin Nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik fokusohen kryesisht në:

Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Standarte të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

Verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;

Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;

Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;

Përfshirjen e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;

Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

**Titulli i gjetjes:** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit,

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi strategjinë e Teknologjisë së Informacionit u konstatua se nuk ekziston një strategji IT, por ka elemente të dokumentuar të saj si plane mbi IT dhe proceset për zhvillimin, aprovim, zbatimin dhe mirëmbajtje të IT.

**Ndikimi/efekti:** Mos pasqyrimin e objektivave lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumentave të nevojshëm për matjen e objektivave, keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së APP.

**Shkaku:** Mos zbatim i praktikave më të mira në këtë fushë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të APP, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi Nr. 6, prot. 8399/6, datë 08.10.2018 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur kanë paraqitur observacionin se:*

*APP përgatit çdo vit analizën e punës për vitin paraardhës duke përfshirë aty në mënyrë të detajuar edhe një analizë të problematikave të hasura si edhe duke përcaktuar objektivat për vitin e ri, pjesë e të cilave janë edhe objektivat që lidhen me Teknologjinë e Informacionit dhe funksionimin e sistemit elektronik të prokurimit.*

*Sa i takon objektivat për vitin 2018, në vijim të VKLM 673, datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", APP është aktualisht në proces diskutimi me AKSHI-n për...Gjithashtu, ju bëjmë me dije se APP është aktualisht duke punuar për hartimin e një strategjie kombëtare për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, pjesë e rëndësishme e të cilës është edhe prokurimi elektronik dhe menaxhimi i sistemit elektronik të prokurimit. Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi problematikën e konstatuar.*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Titulli i gjetjes** App nuk ka menazhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave IT.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se: App nuk ka menazhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave IT në përputhje me Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr, prot 3285 datë 19.03.2018 duke mos udatuar ndryshimet në rregulloret, ndarjen e detyrave të njësisë së Teknologjinë e Informacionit në përputhje me organizimin, strukturën e re.

**Ndikimi/efekti:** Mos menazhimi i ndryshimeve në burimet njerëzore të IT mbart riskun e mos plotësimit të detyrave të kësaj strukture në përputhje me objektivat institucionale.

**Shkaku:** Mos menazhim i ndryshimeve.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi:** APP në të ardhmen të marrë masa për rishikimin e bazës rregullative të strukturave IT në APP në përputhje me çdo ndryshim strukturor të kryer.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi Nr. 6, prot. 8399/6, datë 08.10.2018 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur kanë paraqitur observacionin se:*

*Me miratimin e strukturës së re, ku në zbatim të VKM 673/2017 nuk përfshihet më një ' strukturë TIK, APP ka riorganizuar stafin e TIK, duke e transferuar në pozicione të tjera si edhe duke hartuar përshkrimet e punës për këto pozicione. Përshkrimet e reja të punës janë reflektuar edhe në rregulloren e brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 14, datë 13.09.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilën e gjeni të publikuar në faqen e internetit të APP. Gjithsesi, duke pasur parasysh rëndësinë që ka mirëfunksionimi dhe mirëadministrimi i sistemit elektronik të prokurimit, si dhe faktin që kalimi faktik i administrimit të tij pranë AKSHI-t është ende në proces, me Urdhrin me Nr. 51, datë 10.04.2018, të Drejtorit të përgjithshëm është përcaktuar që specialistë TIK, të vazhdojnë të kryejnë të njëjtat detyra, pavarësisht kalimit të tyre në pozicione të reja. Për sa më sipër grupi i auditimit pranon pjesërisht observacion por mban të njëjtin qëndrim mbi rëndësinë e ndryshimeve në kohë të përshkrimeve të punës dhe rregulloreve.*

Standardet e Praktikave me të mira të rekomandojnë që Qeverisjes TIK duhet të vendosi politika në fushën e IT. Këto politika vendosin kërkesat për mbrojtjen e asetëve të informacionit dhe mund ti referohen procedurave ose mjeteve të tjera në mënyrën sesi këto do të mbrohen. Politikat duhet të jenë të disponueshme ndaj të gjithë punonjësve përdorues të IT.

APP ka vendosur politika e parime në planin e sigurisë (version 3 datë 10.04.2017) si dhe në Politikave të Vazhdueshmerisë së Punës së Institucionit.

**Titulli i gjetjes** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të gjithë punonjësve përgjegjës për sigurinë e informacionit të udhëzimeve mbi sigurinë e informacionit.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të gjithë punonjësve përgjegjës për sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit në kundërshtim me pikën 2 të planit të sigurisë "Qëllimi dhe fusha e zbatimit ku thuhet: "ky udhëzim do të bëhet efektiv duke u zbatuar në mënyrë të detyrueshme nga çdo punonjës i APP. Të gjithë punonjësit duhet të familjarizohen me përmbajtjen e tij dhe ta bëjnë pjesë të menyrës së të menduarit dhe të veprimtarisë së tyre të përditshme.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Ndikimi/efekti:** Risk në mos zbatim të masave të përcaktuara në planin e sigurisë me pasojë cënimin e sigurisë së informacionit.

**Shkaku:** Mos përdorimit të mjeteve të komunikimit të brendshëm (intranet) për përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** APP të marrë masa për zhvillimin e mjeteve të komunikimit të brendshëm për krijimin e faciliteteve të nevojshme të gjithë punonjësve përgjegjës, të udhëzimeve, planeve mbi sigurinë e informacionit.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi Nr. 6, prot. 8399/6, datë 08.10.2018 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur kanë paraqitur observacionin se: ....Në lidhje me konstatimin, se "APP nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion të të gjithë punonjësve përgjegjës për sigurinë e informacionit, përfshirë përdoruesit e sistemeve të cilët kanë rol në mbrojtjen e informacionit në kundërshtim me pikën 2 të planit të sigurisë "Qëllimi dhe fusha e zbatimit ku thuhet: "ky udhëzim do të bëhet efektiv duke u zbatuar në mënyrë të detyrueshme nga çdo punonjës i APP. Të gjithë punonjësit duhet të familjarizohen me përmbajtjen e tij dhe ta bëjnë pjesë së mënyrës së të menduarit dhe të veprimitarisë së tyre të përditshme", sqarojmë se:  
Punonjësit e APP, pavarësisht pozicionit të tyre të punës, njoftohen në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha aktet e reja ..... me anë të e-mailit....Megjithatë APP, duke mbajtur në konsideratë konstatimin tuaj, do të kujdeset që ky dokument t'u bëhet i njohur edhe pjesës tjetër të stafit në mënyrë që të jetë pjesë e veprimitarisë së tyre të përditshme. Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi rëndësinë e pasjes se aksesit në dokumentacionin sensitiv si rregullore etj.*

**Titulli i gjetjes** Me ndryshimet e strukturave IT, APP-së i cënohet pjesa e rëndësishme e Qeverisjes IT. Roli i strukturës IT nuk duhet dhe mund të zëvendësohet me struktura të tjera pasi struktura IT luan një rol të rëndësishëm në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarjes në vendimarrje për problemet e IT.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se: APP pas daljes së VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 sipas së cilës strukturat IT kalojnë në varësi nga AKSHI-t (të APP-së dhe jo vetëm ) ndërmer ndryshime të strukturës IT me Vendimin e Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë së prokurimit Publik nr, prot 3285 date 19.03.2018.

Për sa më sipër APP i drejtohet DAP për propozimin e transferimit të përhershëm të nënpunësve civile në kuadër të restrukturimit i kërkon transferimin e përhershëm të drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së informacionit dhe publikimit si dhe 7 specialistëve, të APP nga Drejtorja, e Informacionit dhe Publikimit në Drejtorinë e Informacionit dhe Publikimit.

**Ndikimi/efekti:** Ulje të rolit IT-së si mjet i rëndësishëm për menaxhimin e lartë për përmbushjen e misionit të APP.

**Shkaku:** VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 (kalimi i strukturave IT në varësi nga AKSHI-t)

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim për përmirësim Ligjor :** Kërkimit KM ndryshimin e VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 pika 23.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Ishte:** Strukturat përgjegjëse së AKSHI-t, Punonjësit aktuale të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK) në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI, brenda datës 31.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënpunësit civil në rastin e mbylljes së ristrukturimit të institucionit, apo Kodt të Punës AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i” të pikës 6 personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fushat e veprimit të këtij vendimi (kalimi i strukturave IT në varësi nga AKSHI-t)

**Shtohet:** Në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, ngelet/krijohen strukturave IT në varësi direkte nga menaxhimi i lartë i institucioneve përkatëse me funksion kryerjen e detyrave të qeverisjes IT.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi Nr. 6, prot. 8399/6, datë 08.10.2018 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur kanë paraqitur observacionin se: ...APP vlerëson maksimalisht rëndësinë dhe rolin që kanë strukturat TIK në drejtim të garantimit të mirëfunksionimit të sistemit elektronik të prokurimit. Gjithsesi, APP është institucion publik dhe si i tillë funksionon në bazë të legjislacionit përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Në këtë kuptim, APP ka vepruar në zbatim të VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", sipas të cilës të gjitha funksionet e lidhura me TIK kalojnë për kompetencë pranë AKSHI-t. Në këto kushte, jemi në pritje të finalizimit të procesit të kalimit përfundimtar të këtyre kompetencave pranë AKSHI-t dhe caktimit nga ana e tyre të specialistëve që do të ngarkohen me funksionet TIK të mbuluara nga APP. Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim mbi rëndësinë e struktura IT në drejtim të qeverisjes IT.*

### **Vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik”**

#### **Informacion i Përgjithshëm mbi çështjen nën auditim**

Për vitin 2017, Autoritetet Kontraktore për plotësimin e nevojave për shërbime mallra e punë civile kanë prokuruar me procedurat e prokurimit elektronik 109,6 miliardë Lekë (fondi total limit)<sup>5</sup>. Shqipëria gjatë vitit 2017 arriti një Produkt të Brendshëm Bruto (PBB) 1,55 miliardë Lekë<sup>6</sup>.

Nga krahasimi i vlerës së prokuruar me PBB rezulton 7% e PBB është prokuruar me procedurat e prokurimit elektronik.



<sup>5</sup> Burimi APP

<sup>6</sup> Bazuar në të dhënat e siguruar nga INSTAT mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB)




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Raporti Fondi Total i prokuruar-PBB**



Krahasuar me të dhënat e vendeve të rajonit, situata paraqitet në grafikët e mëposhtëm:



Vendi	Prokurime/PBB	Buxhet Shpenzime/PBB	Prokurime/Buxhet Shpenzime
Albania	7%	29%	24.3%
Bosnia and Herzegovina	7.10%	41%	17.2%
Croatia	13%	46%	28.0%
Kosovo	6.50%	27%	23.8%
FYR Macedonia	7.80%	32%	24.6%
Montenegro	6.90%	48%	14.3%
Serbia	8.40%	41%	20.3%



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Analiza krahasimore e raporteve të mësipërme të Shqipërisë me treguesit e vendeve të rajonit pasqyrojnë tregues mesatare në krahasim me vendeve të rajonit të fondit të prokuruar ndaj PBB dhe të fondit të prokuruar ndaj shpenzimeve buxhetore<sup>7</sup>

***1. Gjatë vitit 2017 me objektiv rritjen e konkurrencën u lancua për herë të parë aplikacioni “e-Procurement Albania” për ofertimin në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël nëpërmjet smartphone.***

Numri total i ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë në procedurat e shpallura me fitues nga Autoritetet Kontraktore për vitin 2017, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është **169,364**.

Gjatë vitin 2017 në Sistemin e Prokurimit Elektronik janë regjistruar **18337 operatorë ekonomikë** të rinj vendas, të cilët janë regjistruar në SPE, automatikisht pas regjistrimit të tyre në QKB dhe **75** operatorë ekonomikë të huaj, të cilët janë regjistruar direkt në SPE. Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë të regjistruar rishtazi në SPE, ka ndikim në rritjen e konkurrencës në procedurat e prokurimit publik.

**Përdorimi i procedurave me Negocim pa Shpallje Paraprake nga Autoritetet Kontraktore**

Gjatë vitit 2017, Autoritetet Kontraktore kanë vazhduar të përdorin në një shkallë të lartë procedurën me negocim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara gjatë vitit 2017 apo 8.3% të vlerës totale.

Konstatohet se në 67% e rasteve të përdorimit të kësaj procedure janë për mbulimin e nevojave të fillim vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Përdorimi i kësaj metode për të “mbuluar nevojat” e fillimit të vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve mbart risqet:

- keqplanifikimet e nevojave
- shmangien e konkurrencës

me pasojë efektivitet shumë të ulët të prokurimit.

Si rezultat i reformave të ndërmarra nga APP gjatë **përiudhës Tetor 2017 e në vazhdim** është arritur një impakt i menjëhershëm në uljen e numrit të procedurave të prokurimit “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” si rezultat i një sërë masash të ndërmarra nga APP për përmirësimin e kuadrit regullativ për frenimin e fenomenit (shqetësues gjatë vitit 2017 dhe i konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme).

***Masat e ndërmara nga APP për kufizimin e procedurës “negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”***

1. Nxitjen e autoriteteve kontraktore nëpërmjet Njoftimeve dhe Rekomandimeve të nxjerra nga APP, për shpalljen e procedurave të prokurimit me Marrëveshje Kuadër, me qëllim mbulimin e nevojave me mallra dhe shërbime të vazhdueshme, duke shmangur përdorimin e procedurës së prokurimit "negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" për plotësimin e nevojave të pambuluara në fillim të vitit.

---

<sup>7</sup> International Monetary Fund, World Economic Outlook Database, April 2018



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

2. Zhvillimi i procedurës së prokurimit "negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" në sistemin e prokurimit elektronik.

3. Hartimi i Seti përkatës i dokumentave të tenderit, për këtë lloj procedure prokurimi.

4. Hartimi i një Udhëzimi të detajuar për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi e cila do të realizohet me mjete elektronike, Udhëzimi Nr. 02, datë 08.01.2018 "Mbipërdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Nëpërmjet këtij akti nënligjor autoritetet kontraktore u udhëzuan jo vetëm në drejtim të rasteve ligjore të përzgjedhjes së kësaj lloj procedure prokurimi, por edhe në drejtim të zhvillimit të saj, sa i takon procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.


5. Krijimi në sistemin e prokurimit elektronik të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike, ku kjo lloj procedure prokurimi lejohet të parashikohet si element në këtë regjistër, për t'i hapur më pas rrugën e zhvillimit të saj, vetëm pasi nga autoriteti kontraktor të plotësojë kushtet ligjore që parashikon neni 33 i LPP.

6. Rishikimi i Formularit të Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar, si dhe shtojcës përkatëse në setin e dokumentave të tenderit është shtuar një seksion i veçantë, ku kërkohet të specifikohet nga autoriteti kontraktor rasti konkret, sipas pikave të nenit 33 të ligjit për prokurimin publik, të cilit ky i fundit i është referuar në përzgjedhjen e procedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës". Ky formular është i detyrueshëm për t'u plotësuar nga autoritetet kontraktore në rastet e përdorimit të kësaj lloj procedure, identifikimin e të dhënave statikore mbi rastet më të shumta të përdorimit të saj.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2018 procedurat e prokurimit me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës përbejnë 10 % ndaj procedurave konkurrese të publikuara në sistem, shifër kjo që është mjaft e ulët në krahasim me 3 mujorin e parë të vitit 2017.

Nga analiza krahasimore e përdorimit të procedurës "**Me Negocim pa Shpallje Paraprake**" nga Autoritetet Kontraktore gjatë tremujoreve të parë të viteve 2017 dhe 2018 tregojnë se megjithë uljen e fondit të përdorur me këtë procedurë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 niveli i efektivitetit të prokurimit ngelet i ulët.

Procedura me negociim pa shpallje







**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

AK dhe APP duhet të analizojnë shkaqet e këtij fenomeni duke ngushtuar hapësirat ligjore që lejojnë keq përdorimin e kësaj procedure prokurimi.


Gjatë vitit 2017 janë shpallur (publikuar) 7317 procedura prokurimi për shërbime mallra e punë civile me strukturë:



Për sa më sipër janë alokuar 109,619,600,197 lekë për plotësimin e nevojave të AK për Punë Civile, Shërbime e Mallra të ndara:



Struktura e Procedurave të prokurimit të përdorura paraqitet:






**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit total	I Ndarë		
			Shërbime	Mallra	Punë Civile
I Hapur Lokal	2323	86,473,454,498	11,449,584,393	25,686,760,242	49,337,109,863
Kërkesë për Propozim	4828	10,349,508,259	2,568,816,152	4,880,362,101	2,900,330,006
Shërbim Konsulence	137	1,646,293,649	1,646,293,649	0	0
I Hapur mbi Kufi	29	11,150,343,791	4,475,666,240	5,273,201,093	1,401,476,458
<b>TOTAL</b>	<b>7317</b>	<b>109,619,600,197</b>	20,140,360,434	35,840,323,436	53,638,916,327

79% të vlerës së procedurave të shpallura e zënë procedura i hapur lokal (32% në numër procedure) ndërsa lloji më i përhapur në numër 66% e zë Kërkesa për propozim (9% në vlerë)

Nga 7317 procedura të publikuara me fond limit total 109,619,600,197 lekë rezulton se 19% të procedurave apo 20,309,697,332 lekë janë anuluar, ecuria e procedurave paraqitet:



Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit
Nr.Total i Procedurave të publikuara	7317	109,619,600,197
Nr. Total i Procedurave të Anulluara	2428	20,309,697,332
Nr.Total i Procedurave të vazhduara	4889	89,309,902,865

Shkalla prej 19% e anulimit të procedurave tregon se puna e Autoriteteve Kontraktore për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim.

Mos kryerja në kohë e investimeve duhet të kosiderohet jo vetëm si mos efektivitet në përdorimin vlerave por impakti negativ i tyre ka një spektër me të gjërë dhe kërkon një analizë rast pas rasti nga AK dhe APP për nxjerjen e arsyeve të këtyre dështimeve me qëllim përmirësimin e kornizës rregullatore të zhvillimit të tyre.


**Shpërndarja sipas llojit të procedurës**

Lloji i procedurës	Nr	Fondi limit	Fondi i Prokuruar
I Hapur Lokal	1,734	75,418,424,237	68,592,754,761
Kërkesë për Propozim	2,897	7,376,339,086	6,713,123,322
Sherbim konsulence	87	1,374,859,260	1,322,550,062
I Hapur mbi kufi	31	9,012,964,609	8,402,046,326
<b>TOTAL</b>	<b>4,749</b>	<b>93,182,587,192</b>	<b>85,030,474,472</b>




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).



Shpërndarja e prokurimeve nga AK sipas vlerës së prokuruar për mallra shërbime .....




### Efektiviteti i procedurave të prokurimit publik viti 2017

Nr.Total i Proç.te fituara	4749
Fondi total limit	93,182,587,192
Fondi total i prokuruar	85,030,474,472
% qe ze Fondi i prokuruar ndaj Fondit limit	91,3
Fondi total i kursyer	<b>8,152,112,720</b>
% qe ze Fondi i kursyer ndaj Fondit limit	8,7



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**




Me efektivitet 0% paraqiten .....975 raste me me fond 17,166,562,192 lekë  
 Me efektivitet 1-5% paraqiten.....1546 raste me me fond 32,284,408,628 lekë  
 Me efektivitet 6-35% paraqiten.....7304 raste me fond 26,346,537,901 lekë  
 Me efektivitet 36- 99% paraqiten.....257 raste me fond 2,367,949,639 lekë


**Përmirësimi i planifikimit të procedurave të prokurimit**

Planifikimi i kujdesshëm dhe në kohën e duhur i procedurave të prokurimit është një nga kushtet kryesore për rritjen e efencës në përdorimin e fondeve publike

Shpërndarje e kryerjes së publikimit të procedurave për muajt Janar - Dhjetor 2017



Shpërndarje e kryerjes së procedurave me lidhje Kontrate për muajt Janar - Dhjetor 2017



Nga analiza e procedurave të publikuara dhe të kryera me përfundim lidhje kontrate rezultojnë me risk 393 procedura me fond të prokuruar 8,767,669,428 të cilat janë lidhur në muajt janar-



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).


shkurt si rrjedhojë e kohës se limituar ne përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit te procedurave se prokurimit.

Paraqesin risk të ulët në lidhje me kohën e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit të procedurave së prokurimi 3921 procedura me fond të prokuruar 68,014,329,660 të cilat janë lidhur në muajt mars-nëntor.

Paraqesin risk të lartë në lidhje me kohën e nevojshme për zbatimin e kontratave 435 procedura me fond 8,248,475,384 të cilat janë lidhur në muajin dhjetor 2017.

#### **Procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore**

Procedurat e prokurimit për barna, reagentë e pajisje mjekësore nga 58 Autoritetet Kontraktore janë zhvilluar 506 procedura prokurimi me fond limit total 86,928,267,147 duke arritur një efektivitet prej 9%. Nga analiza e shpërndarjes se këtyre procedurave rezulton se vetëm 10 operatorë ekonomike kanë fituar 40% të fondit të prokuruar 993,569,640 lekë me efektivitet 0%




Nga analiza e efektivitetit rezulton se 484 procedura kanë rezultuar me efektivitet të ulët (0 ose rreth 0)



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).



Procedurat e prokurimit për barna reagonte e pajisje mjekësore 65 OE kanë fituar 494 procedura prokurimi me fond të prokuruar 2,445,991,325 lekë me efektivitet 0.

Nga analiza e shpërndarjes së procedurave të prokurimit të barnave e paisjeve mjekësore me efektivitet 0 rezulton se vetëm 5 OE kanë fituar 282 procedura (nga 494 totali me efektivitet 0) duke përfituar 40% (apo 2,445,991,325 lekë) të fondit të prokuruar.

#### **Zhvillimi i procedurave të prokurimit mbi fondin limit**

Nga analizimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit për vitin 2017 rezultojnë se në 14 raste fondi i prokuruar (609,887,131 lekë) është më i madh se fondi limit (395,611,677 lekë) në vlerën -214,275,454 lekë.

Nga ky verifikim rezulton se sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për mos lejimin e hedhjes të të dhënave gabim, apo të rasteve ku është lidhur kontratë pa pasur fondin limit të nevojshëm .

**Nga krahasimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga APP me të dhënat me burim sistemin SIFQ për autoritetet kontraktore si Bashkia Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Shëndetësisë (QSUT), Fondi Shqiptar i Zhvillimit, evidentohen këto fenomene:**

1. Data e regjistrimit të Urdhër Prokurimit në SIFQ është me e hershme se data e publikimit të Prokurimit në APP.
2. Data e nënshkrimit të kontratës sipas SIFQ është me e hershme se data e nënshkrimit të kontratës në APP.
3. Vlera e kontratës sipas SIFQ është më e vogël se vlera kontratës sipas APP.
4. Vlera kontratës sipas APP është më e vogël se buxheti në momentin e nënshkrimit të kontratës.

#### **Marrëveshjet Kuadër**

Gjatë vitit 2017, autoritetet kontraktore kanë vazhduar të përdorin Marrëveshjen Kuadër, të fokusuar kryesisht në shërbimin e blerjes së biletave të udhëtimeve, konsulence, shërbime shëndetësore, apo riparime automjete e pajisje.



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

Në muajin Dhjetor 2017 autoritetet kontraktore filluan me përdorimin e Marrëveshjeve Kuadër, të fokusuar në shërbimin e Ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private gjithashtu gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 është përdorur në 453 raste nga AK përdorimi i Marrëveshjeve Kuadër edhe për rastet e Minikontratave me vlerë totale të kontratës prej 205,571,021 lekë

Me konkretisht përdorimi i kësaj procedure për vitin 2017 paraqitet:

Marrëveshje Kuadër të shpallura dhe të nënshkruara Janar-Dhjetor 2017

	Publikuar		Lidhur kontratë			
	Numër	Fondi total Limit i prokuruar	Numër	Fondi total limit i prokuruar ( vlera në lekë)	Vlera totale e fituar (vlera në lekë)	Efektiviteti%
I Hapur Lokal	21	492,712,768	13	373587372	352728602	6
Kërkesë për Propozim	38	154,775,619	21	88213094	88204866	0
Shërbim Konsulence	2	132,816,560	3	132816560	113596900	14
Totali	61	780,304,947	36	594617026	554530368	7

Krahas punës se kryer nga AK dhe APP për të stimuluar përdorimin e Marrëveshjes Kuadër, si një instrument i rëndësishëm për përmbushjen e nevojave të vazhdueshme të autoriteteve kontraktore nëpërmjet procedurave transparente dhe konkurruese, shikohet se shkalla e përfundimit të procedurave është rreth 44% (në nr. dhe vlerë) me një efektiviteti në nivele relativisht të ulët (7%).

Për sa konstatohet kërkohet që përzgjedhja e nevojës për zbatimin e marrëveshjeve kuadër të shikohet rast pas rasti me objektiv krahas sigurimin në kohë të shërbimeve mallrave edhe rritjen e transparencës konkurruese e efektivitetit të kësaj procedure.

Nga ana e APP kërkohet që pas një analize të hollësishme të situatës si dhe përdorimit të eksperiencave me të mira të vendit e të huaja kryejë shikimin e kuadrit rregullator e Marrëveshjes Kuadër.

#### **Risk në zhvillimet vitit 2017-2018 për përqendrimin e prokurimeve publike**

Gjatë vitit 2017 me VKM nr. 673 datë 22.11.2017 u ngarkua AKSHI që përcaktojë specifikimet e pajisjeve për projektet e teknologjisë së informacionit për institucionet e administratës së lartë publike dhe për institucionet e varësisë si dhe do të zhvillojë procedurat e prokurimit për to.

Në fillim të vitit 2018 me VKM nr. 81. datë 14.02.2018 krijohet Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) e cila ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

ABP i ngarkohet detyra e unifikimit të specifikimeve, kryerjes së procedurave të prokurimit dhe monitorimin e zbatimit të kontratave.




**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Risqet nga këto organizime:

- mos menaxhimit të ndryshimeve
- kalimi i punonjësve nga status të nënpunësit civil në punonjës të punësuar me kod pune çënon integritetin e punonjësve të këtyre punonjësve për kryerjen e detyrës.

**Mbi matjen e performancës në procedurat e prokurimit punime civile zëri “Rrugë-Ura”**

Nga auditimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit elektronik që kanë çuar në lidhje kontrate rezulton se për punime civile, zëri “Rrugë-Ura” janë prokuruar 386 procedura me fond limit pa TVSH **24,949,402,753** lekë dhe fond të prokuruar pa TVSH **20,924,750,552** lekë duke siguruar një efektivitet 16% (në këtë analizë janë përjashtuar 4 rastet efektivitetit negativ mëposhtme).



Me efektivitet rreth 0% paraqiten .....35 raste me fond të prokuruar 20,914,824,080 lekë  
Me efektivitet 1-5% paraqiten.....141 raste me fond të prokuruar 5,900,675,091 lekë  
Me efektivitet 6-20% paraqiten.....94 raste me fond të prokuruar 5,965,289,279 lekë  
Me efektivitet 21- 49% paraqiten.....112 raste me fond të prokuruar 6,393,736,358 lekë

Nga auditimi i bazës së të dhënave të procedurave të prokurimit elektronik që kanë çuar në lidhje kontrate rezulton se për civile zëri “rrugë” me efektivitet negativ janë prokuruar 4 procedura me fond limit pa TVSH 8,561,919 lekë dhe fond të prokuruar pa TVSH 9,926,472 lekë.


Procedura e përdorur :

- “i hapur lokal” 97% në vlerë dhe 62% në numër procedurash
- “kërkesë për pozim” .


*Procedurat e prokurimit të përdorura për punime civile zëri “Rrugë-Ura” viti 2017*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**



*Shpërndarja e fondit të prokuruar për punime civile zëri “Rrugë-Ura” për vitin 2017 sipas AK*



*Shpërndarja e fondit të prokuruar për punime civile zëri “Rrugë-Ura” për vitin 2017 sipas A*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**



Nga analiza e shpërndarjes së këtyre procedurave rezultojnë se vetëm 5 operatorë ekonomike kanë fituar 20 % të fondit të prokuruar 4,295,567,871 lekë me efektivitet 16 %.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr.7, datë 08.10.2018 për të cilën nga personat me të cilën është mbajtur kanë paraqitur observacionin:*

**1. Në gjetjen 1 të akt konstatimit ..Gjithsesi, për sa keni konstatuar bëjmë me dije se, si rezultat i reformave të ndërmarra nga APP gjatë periudhës Tetor 2017 e në vazhdim është arritur një impakt i menjëhershëm në uljen e numrit të procedurave të prokurimit "negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës"....**

**Për sa më sipër grupi i auditimit vlerëson masat e marra dhe mban të njëjtin qëndrim gjetjet për vitin 2017 .**

**2. Në gjetjen 2 të akt konstatimit .. sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e e nevojshëm për moslejimin e hedhjes së të dhënave gabim, ....Pasqyra bashkëlidhur evidenton se, 10 (dhjetë) nga 14 (katërmëdhjetë) procedurat që ju keni evidentuar, rezultojnë se janë procedura të zhvilluara në vitin 2016, por janë shpallur fitues në vitin 2017, si dhe janë nënshkruar kontratat po në vitin 2017. ....Në konstatimet tuaja vërehet se keni bërë diferencat midis vlerave të kontratave që përfshijnë TVSH-në, me fondin limit përkatës, ku theksojmë se nuk përfshihet TVSH-ja.....Për të argumentuar sa më sipër, bashkëlidhur po ju paraqesim pasqyrën me vlerat reale të nxjerra nga Sistemi i Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe printimet nga BNJP për këto procedura.**

**Për sa më sipër grupi i auditimit nuk merr parasysh observacionin për gjetjen nr.2 dhe mban të njëjtin qëndrim.**

**3. Në lidhje me gjetjen tuaj se, nga krahasimi me vendet e rajonit konstatohet se megjithë eksperiencën dhe punën e bërë niveli i përdorimit të prokurimit elektronik gjatë vitit buxhetor 2017 është relativisht i ulët., sqarojmë si më poshtë vijon:.....Në këtë kuptim, konstatimi juaj se, përdorimi i prokurimit elektronik gjatë vitit buxhetor 2017 është relativisht i ulët nuk qëndron dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Nga ana tjetër, sa i takon krahasimit të bërë nga ana juaj me vendet e rajonit theksojmë se të dhënat që ju i jeni referuar janë marrë nga krahasimi i vlerës së prokuruar me produktin e brendshëm bruto (PBB), nga ky rezultat se vetëm 7 % e PBB është prokuruar. Pra, ky tregues 7% nuk do të thotë që përdorimi i prokurimit elektronik gjatë vitit buxhetor 2017 është relativisht i ulët por kjo është vlera e prokuruar krahasuar me PBB....**

**Për sa më sipër grupi i auditimit ndan të njëjtin mendim me subjektin se treguesi 7% nuk do të thotë që përdorimi i prokurimit elektronik gjatë vitit buxhetor 2017 është relativisht i ulët por kjo është vlera e prokuruar krahasuar me PBB....**

**4. Sa i takon gjetjes tuaj se, gjatë tremujorëve të parë të viteve 2017 e vitit 2018 megjithë uljen e fondit të përdorur me këtë procedurë (negociim pa shpallje) niveli i efektivitetit të prokurimit mbetet i ulët sqarojmë se, lidhur me këtë konstatim jemi shprehur edhe më sipër në**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*Për sa më sipër grupi i auditimit duke vlerësuar masat e mara ka evidentuar efektivitetin e ulët për lenien e rekomandimit për vazhdimin e punës së nisur nga APP ndaj nuk merr parasysh observacionin për gjetjen nr.4 dhe mban të njëjtin qëndrim.*

*5. Sa i takon gjetjes tuaj se, procedurat e prokurimit kanë një shkallë të lartë 19% të anulimit të procedurave të prokurimit publik ju sqarojmë se, kjo shifër i referohet vlerës së fondit.*

*Për sa më sipër grupi i auditimit ndan të njëjtin mendim me subjektin se treguesi 19% i referohet vlerës së fondit limit (pasi janë procedura te anuluar).*

**Titulli i gjetjes:**

Autoritetet Kontraktore gjatë vitit 2017 kanë përdorur në një shkallë të lartë procedurën me negociim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara apo 8.3% të vlerës totale.

Konstatohet se në 67% e rasteve të përdorimit të kësaj procedure janë për mbulimin e nevojave të fillim vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Përdorimi i kësaj metode për të “mbuluar nevojat” e fillimit të vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve mbart risqet: keqplanifikimet e nevojave dhe shmangien e konkurrencës, me pasojë efektivitet shumë të ulët të prokurimit.

Nga analiza krahasimore e përdorimit të procedurës “Me Negocim pa Shpallje Paraprake” nga Autoritetet Kontraktore gjatë tremujoreve të parë të viteve 2017 dhe 2018 tregojnë se megjithë uljen e fondit të përdorur me këtë procedurë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 niveli i efektivitetit të prokurimit mbetet i ulët.

**Situata:** Autoritetet Kontraktore gjatë vitit 2017 kanë përdorur në një shkallë të lartë procedurën me negociim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara apo 8.3% të vlerës totale. Në fund të vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018 situata është përmirësuar ndjeshëm si rezultat i masave të mara nga APP, por efektiviteti i procedurave të prokurimit ngelet i ulët

**Ndikimi/efekti:** Mos efektivitet të fondeve

**Shkaku:** Hapësira në bazën ligjore regullative

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** APP të duke vazhduar punën e nisur në fund të vitit 2017 të mari masa për përmirësimin e legjislacionit në fuqi me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurës procedurës “Me Negocim pa Shpallje Paraprake”.

**Titulli i gjetjes:**

Sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për mos lejimin e hedhjes të të dhënave gabim, apo lejuar lidhjen e kontratave pa pasur fondin limit të nevojshëm në 14 raste fondi i prokuruar (609,887,131 lekë) është më i madh se fondi limit (395,611,677 lekë) në vlerën -214,275,454 lekë.

**Situata:** Nga auditimi i bazës së të dhënave u konstatuan parregullsi të cilat evidentojnë mungesën e kontrolleve të input të të dhënave



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Ndikimi/efekti:** I lartë

**Shkaku:** Mungesë e kontrolleve, keq formatim të fushave, gabime në gjenerim raportesh (output).

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** APP të marri masat e nevojshme për vendosjen në bazen e të dhënave të sistemit të prokurimit publik të filtrave të nevojshëm si dhe kontrolleve në input e të dhënave

**Titulli i gjetjes:**

2.1 Procedurat e Prokurimit të shpallura kanë një shkallë të lartë prej 19% të anulimit (vlerës së fondit), duke treguar se puna e AK për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim. Mos kryerja në kohë e investimeve duhet të konsiderohet jo vetëm si mos efektivitet në përdorimin e burimeve por impakti negativ i tyre ka një spektër me të gjërë.

2.2 Nga analiza e procedurave të publikuara dhe të kryera me përfundim lidhje kontrate rezultojnë me risk 393 procedura me fond të prokuruar 8,767,669,428 lekë të cilat janë lidhur në muajt janar-shkurt si rrjedhojë e kohës së limituar në përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Paraqesin risk të lartë në lidhje me kohën e nevojshme për zbatimin e kontratave 435 procedura me fond 8,248,475,384 të cilat janë lidhur në muajin dhjetor 2017.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se 19% Procedurave të Prokurimit të shpallura janë anuluar (vlerës së fondit). Zhvillimi i procedurave pa pasur kohën e nevojshme gjatë muajve janar dhe dhjetor.

**Ndikimi/efekti:** Mos kryerja në kohë e investimeve, mos efektivitet në përdorimin e burimeve.

**Shkaku:** Puna e AK për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** APP të kryejë monitorimin dhe vlerësimin e situatës dhe të ndërmarë përmirësimet e nevojshme në aktet regullatore të procedurave të prokurimit për minimizimin e fenomeneve të cilat ulin performancën e prokurimit publik.

***b. Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK***

APP e ushtron aktivitetin e saj me 28 punonjës për vitin 2018 dhe 29 punonjës në strukturën e miratuar për vitin 2018. Struktura e miratuar për vitin 2018 në ndryshim me atë të vitit 2017 në APP ka sjellë ndryshim në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit e cila ndryshon emrin në Drejtoria e Informacionit dhe Publikimit, dhe pjesërisht objektivin ku më kryesoret do të jenë monitorimi i problematikave të ndryshme në sistemin e prokurimit dhe nxjerrjen e statistikave të ndryshme.

Punonjësit pjesë e strukturës TIK kanë të gjithë të njëjtin emërtim “specialistë IT” dhe kanë të njëjtin përshkrim pune sipas kategorisë së paracaktuar nga departamenti i administratës publike



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

edhe pse detyrat e tyre mund të kenë nevojë për kualifikime të ndryshme. Përshkrimi i punës për specialistët IT nuk bazohet në detyrat që ata kryejnë, por me përshkrim pune të njëjtë për të gjithë specialistët.

Sistemet kompjuterike po bëhen gjithmonë e më shumë komplekse, vendimarrja po bazohet në të dhënat që regjistrohen e përpunohen nga këto sisteme.

Një specialist që ushtron detyrën për mirëmbajtjen dhe monitorimin e pajisjeve fizike (Hard) apo dhe monitorimin e kontratave që i përkasin kësaj kategorie, duhet të ketë eksperiencë apo një specialist i cili duhet të ketë eksperiencë apo kualifikime në sistemet Soft, vetë pozicioni kërkon kualifikime dhe trajnime që i përkasin kategorisë për të cilën është punësuar.

#### **Përgjegjësitë dhe detyrat e dokumentuara**

Struktura e teknologjisë së informacionit, për vitin 2017 ka patur 4 specialistë dhe Drejtorin e drejtorisë, të cilët kanë ushtruar detyra që i takojnë mirëmbajtjes, raportimit apo statistikave të ndryshme si dhe garantimit të mbarëvajtjes për sistemin elektronik të prokurimit.

Në Mars të vitit 2018, komisioni i ristrukturimit në APP, me anë të shkresës me nr.3285, datë 19.03.2018, i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike transferimin për të njëjtët punonjës në pozicione paralele, në drejtorinë e informacionit dhe publikimit dhe në drejtorinë e Koordinimit dhe monitorimit. Aktualisht, janë po të njëjtët specialistë ku krahas raporteve statistikore të ndryshme, ushtrojnë dhe detyrat e specialistëve të teknologjisë për monitorimin e sistemit elektronik të prokurimit, për një periudhë tranzitore deri në riorganizimin e AKSHI-t, sipas VKM nr.673, datë 22.11.2017 “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, sipas së cilës marrëdhëniet e punës për specialistët IT të cdo institucioni do të jenë në varësi të AKSHI-t.

Në rregulloren e miratuar për sigurinë me nr. 8904/7, datë 10.04.2017 “Plani i sigurisë i rishikuar”, në paragrafin 4.1.1.4 “Administratori i sistemit kompjuterik”, renditen veprimet që ndalohen të kryhen nga administratori.

Nga auditimi në përshkrimet e punës së punonjësve 4 specialistë gjithsej, nuk rezulton se administrator është ndonjëri prej tyre, çfarë do të thotë se përcaktimet në rregullore nuk adresohen në përputhje me përshkrimet e punës.

APP i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (AKSK) respektivisht me anë të shkresave me nr.1578/3 dhe nr.1578/4, datë 21.02.2017, duke kërkuar pjesëmarrjen e specialistëve të saj në trajnimet që organizohen për teknologjinë e informacionit lidhur me: rrjetin fizik, sigurinë e informacionit, Produktet Microsoft, Cisco etj. Trajnimet specialistët jo vetëm që nuk i kanë kryer, por APP nuk ka marrë as përgjigje për ndonjë planifikim në të ardhmen.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 1, datë 08.10.2018, për të cilin nga ana e subjektit është observuar me anë të shkresës nr. 9168/1, datë 15.10.2018, në lidhje me:*

*I.Qëllimi kryesor i komunikimit që APP ka patur me AKSHI-n dhe AKSK, ka qenë identifikimi i kurseve të trajnimit sipas fushave përkatëse, sqarojmë se:*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*AKSHI dhe AKSK nuk mund të identifikojnë nevojat për trajnim që ka cdo institucion, nevojat specifike identifikohen nga vetë instiucioni për arsye të natyrës specifike që secili mbart. Gjithashtu pozicioni Oficer Sigurie është një pozicion që më shumë se sa AKSHI-t i takon të jetë pjesë e strukturës së APP, për arsye që i kemi përmendur dhe në aktkonstatimin e mbajtur për këtë pikë. Raportimi i pozicionit Oficer Sigurie, duhet jetë në nivelin më të lartë drejtues të APP bazuar në përgjegjësinë që i jep ligji për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave të prokurimit publik si dhe standartet ndërkombëtare, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia dhe mund të shmanget konflikti i interesit, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.*

*Në lidhje me Pozicionin Help Desk për shkak të ndryshimeve strukturore të AKSHI-t sqarojmë se, nga ana juaj duhet të identifikohen elementë të suportit që punonjësit tuaj kanë ofruar dhe vazhdojnë, në mënyrë që ky suport të transferohet si detyrim tek stafi IT që do të vendoset në dispozicionin tuaj në zbatim të VKM nr.673, datë 22.11.2017.*

**Titulli i gjetjes:** Përcaktimi i detyrave dhe trajnimeve

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se:

- a. Përshkrimet e punës ku janë transferuar specialistët IT, nuk kanë ndryshuar shumë nga detyrat e mëparshme që po të njëjtët specialist kryenin.
- b. Në asnjë përshkrim pune nuk janë pasqyruar përgjegjësitë që lidhen me sigurinë rregullorja e sigurisë paragrafi 5.1 “Rregullorja për organizimin e punës në APP”.
- c. Nuk rezultojnë të dokumentuara detyrat e përkohshme që kryejnë deri në plotësimin e strukturës me specialist IT nga AKSHI.
- d. Detyra të përcaktuara në rregulloren e sigurisë si prsh “**Administrator**” nuk adresohen në përputhje me përshkrimin e punës së punonjësve.
- e. Specialistët e TIK jo vetëm që nuk kanë kryer trajnime për periudhën object auditimi, por APP nuk ka marrë as përgjigje për ndonjë pjesëmarrje në të ardhmen nga insitucionet të cilave ju është drejtuar AKSHI-t dhe AKSK.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e dokumentimit të saktë të punës, që çdo punonjës kryen apo i kërkohet të kryejë, nuk lejon gjurmimin, vlerësimin, performancën, promovimin apo përcaktimin e nevojave në njohuri për secilin prej tyre. Mungesa e koordinimit të saktë të rregullores me përshkrimet e punës dhe anasjelltas, rrit mundësinë që veprimet e ndaluara me rregullore, si shembull pozicioni Administrator, të kryhen nga çdo punonjës që ka të drejta administrative në system.

**Shkaku:** Mungesë rakordimi ndërmjet përshkrimeve të punës dhe rregullores së sigurisë.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** APP të rishikojë përshkrimin e punës për çdo punonjës, për të përcaktuar sa më afër detyrave reale që specialistët e saj kryejnë ku të përcaktojë dhe detyrat funksionale që dhe të identifikojë detyrat e përkohshme, të cilat kryhen aktualisht nga specialistët e saj por që do të transferohen tek AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”.



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

APP si insitucioni i vetëm që administron procesin e prokurimit mundësuar nëpërmjet një sistemi, duhet të monitorojë dhe garantojë integritetin e të dhënave që hyjnë dhe përpunohen në këtë sistem. Në funksion të mbrojtjes së të dhënave nga ndërhyrje të jashtme dhe të brendshme, APP ka përcjell pranë DAP me shkresën nr.8978, datë 19.07.2016 nevojën për oficer sigurie, njëkohësisht dhe si rekomandim të KLSH nga auditimi i mëparshëm.

**Nga auditimi rezulton se për ky pozicion i kërkuar nga APP nuk është miratuar në strukturën e saj gjatë periudhës objekt auditimi.**

Pozicioni për oficerin e sigurisë në rregullore me nr. 8904/7, datë 10.04.2017, në paragrafin 4.1.1.1 është parashikuar të raportojë tek drejtori i drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit, kur ky i fundit ka të gjitha përgjegjësitë të shqyrtojë dhe të përcaktojë përgjegjësitë në rregullore.

Shqyrtimi i rregullores mbi sigurinë dhe ndarja e përgjegjësisë kërkon përfshirjen e të gjerë pasi vetë rregullorja nuk kërkon zbatim vetëm nga specialistët e fushës, për arsye se integriteti dhe konfidencialiteti janë detyrë e të gjithë punonjësve pavarësisht nivelit të aksesit që ata disponojnë.

**Nga auditimi rezulton se, raportimi i Oficer të Sigurisë nuk është kërkuar të kryhet në nivelin më të lartë drejtues të APP, sic kërkohet bazuar në standartet ndërkombëtare dhe eksperiencat më të mira, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia e tij dhe mund të shmangen konfliktet e interesit që lindin, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.** Ky ndryshim kërkon rishikim të rregullores së sigurisë me miratimin e shtimit të këtij pozicioni në strukturën e APP.

Përmirësimet dhe zhvillimet e sistemit elektronik të prokurimit i shërbejnë monitorimit dhe zhvillimit të procedurave në mënyrë shumë më efektive, por kjo nuk është shoqëruar me rritje të numrit të punonjësve që duhet të suportojnë zhvillimet e reja, duke patur parasysh dhe nevojën për suport që autoritet kontraktore kanë në mënyrë të vazhdueshme.

**Nga auditimi rezulton se numri i specialistëve të teknologjisë së informacionit ka qenë shumë i vogël, kur kërkesa për disponibilitetin e sistemit të prokurimit ka qenë dhe është 24 orë në 7 ditë të javës, e kur po të njëjtët punonjës duhet të ofrojnë dhe asistencë teknike për probleme të ndryshme që mund të hasin autoritetet kontraktore pasi APP nuk ka kërkuar të shtojë në strukturën e saj edhe “Help Desk” .**

**Titulli i gjetjes:** Pozicioni Officer Sigurie

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se pozicioni i kërkuar për Oficer Sigurie nga APP nuk është miratuar në strukturën e saj gjatë periudhës objekt auditimi. APP nuk disponon as ndonjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë e cila ka qenë një rekomandim nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

**Ndikimi/efekti:**

**Shkaku:** Oficer i Sigurisë është një pozicion i pa njohur në Institucionet shtetërore.

**Rëndësia:** I mesëm



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Rekomandimi:** APP nën përgjegjësinë që i jep ligji për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave të prokurimit publik, të rikërkojë ndryshim të strukturës për pozicionin Officer Sigurie i cili edhe pse formimin mund ta ketë të bazuar në Teknologjinë e Informacionit nuk është pjesë e strukturës së TIK, por raportimi i tij duhet jetë në nivelin më të lartë drejtues të APP bazuar në standartet ndërkombëtare, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia dhe mund të shmangët konflikti i interesit, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.

**Titulli i gjetjes:** Pozicioni Help Desk

**Situata:** Nga auditimi rezulton se numri prej 4 specialistësh në teknologjinë e informacionit për vitin 2017 ka qenë shumë i vogël, për ofrimin e asistencës teknike për probleme të ndryshme që mund të hasin autoritetet kontraktore si dhe garantimin e disponibilitetit të sistemit të prokurimit që është 24 orë në 7 ditë të javës.

**Ndikimi/efekti:** Ngarkesë me detyra të cilat nuk kanë nevojë domosdoshmërisht për specialist të TIK

**Shkaku:** Help Desk është një pozicion i pa njohur në Institucionet shtetërore

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** APP të identifikojë të gjitha detyrat lidhur me asistencën teknike që janë realizuar nga specialistët e saj, që të parashikojë saktë delegimin e tyre tek specialistët e TIK që do të vihen në dispozicion nëpërmjet AKSHI-t.

**Pika 2. “Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit”**

***a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK***

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

Gjatë vitit 2016, në kuadër të zhvillimit të grantit konkurues “Shqipëria Digitale”, financuar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), Agjencia e Prokurimit Publik (APP) aplikoi duke paraqitur projektin për infrastrukturën e re të Sistemit të Prokurimit Elektronik dhe Arkivës Elektronike.

APP arriti të nënshkruante kontratën me nr. 8812 prot, datë 14.07.2016, me objekt “*Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve/shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur nga një teknologji dhe infrastrukturë e re*”.

Sipas kësaj kontrate, afati për implementimin e projektit ka filluar me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët kontraktuese dhe ka përfunduar në datë 07.04.2017, dhe më pas nga momenti i mbarimit të implementimit të projektit, ka filluar zëri nr. 5 “Mirëmbajtje” në tabelën e shërbimeve, afati i të cilit është 2 (dy) vite kalendarik.

Duke qenë se sistemi është ndërtuar gjatë vitit 2007, teknologjitë e përdorura i përkisnin asaj kohe ose pak më herët.

-Sistemet e shfrytëzimit: Microsoft Windows 2003 Server (Standard Edition) me .NET version 2.0; i bërë “upgrade” në Windows Server 2012 deri në 2016.



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

-Database engine: Microsoft SQL Server 2005 (Standard Edition); i berë “upgade” në SQL Server 2008 deri në 2016.

-Application server: WebAssembler.NET® 2006 Server prodhuar nga Alfa XP Web Software, LLC që përfshin portalin si kornizë integruese (integration framework).

Pas përfundimit të implementimit të projektit, teknologjitë e sistemit të prokurimit elektronik (SPE) janë në versionet:

-Sistemet e shfrytëzimit: Windows Server 2012

-Database engine: Microsoft SQL Server 2016.

-Application server: Platforma e core-it e sistemit është përsëri WebAssembler por e përditësuar në versionin e fundit të tij.

Informacion në lidhje me Sistemin e Prokurimit Elektronik i cili hostohet pranë Data Center-it të AKSHI-t:

<b>Datat e implementimit të sistemit (fillim-mbarim):</b>	14.07.2016 - 07.04.2017 faza e implementimit, nga 08.04-2017 e në vijim, 2 vite kalendarike është faza e mirëmbajtjes së sistemit.
<b>Vlera e investimit për implementimin e sistemit:</b>	132,945,864
<b>Vlera e paguar:</b>	132,945,864
<b>Vlera e mbetur për tu paguar:</b>	
<b>Teknologjia e sistemit:</b>	.net framework
<b>Backup Sistemi</b>	Po, pajisje e backup-it Tape “MSL 2024”
<b>Datat e mirëmbajtjes të sistemit</b>	Data fillimit:08.04.2017 Data e mbarimit:08.04.2019
<b>Vendi ku hostohet</b>	Platforma (Site primar i SPE) hostohet tek Data Centeri i AKSHI, ndërsa site për vijueshmërinë e shërbimit (Business Continuity) hostohet tek dhoma e serverave në APP. Sistemi i Prokurimit Elektronik është i përbërë nga: Sistemi i Prokurimit Elektronik dhe Sistemi i Arkivës Elektronike. Sistemi i Arkivës Elektronike, pas implementimit të projektit është ndarë në Arkivë e Re e cila ndodhet e hostuar sëbashku me SPE tek AKSHI dhe Arkiva e vjetër, e cila ndodhet e hostuar pranë APP.

Ri-inxhinierimi i strukturës së të dhënave dhe ngritja e platformës aktuale të sistemit (framework) në versionet me të reja me qëllim rritjen e performancës së SPE dhe shmangies sa me shumë të incidenteve që vijnë për shkak të saj.

Sa më sipër, platforma e core-it e sistemit është WebAssembler e përditësuar në versionin e fundit të tij.

Kjo mundëson aksesimin e SPE nga përdoruesit nëpërmjet pajisjeve mobile (cross-platform), tablet (cross-platform) dhe personal computer (bazuar në browser).

Gjithashtu, është bërë ndarja e përdoruesve në tre grupe të cilët komunikojnë me sistemin:

-Përdoruesit e Portalit



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

-Përdoruesit Mobile

-Përdoruesit e Sistemit Elektronik;

Këto tre komponente mbështeten nga tre databaza:

-Databaza e portalit, e cila ruan të dhënat që kanë lidhje me portalin si publikime njoftimesh apo dhe dokumentacion statik.

-Databaza publike e njoftimeve të shpalljes, e cila përdoret vetëm nga Operatorët Ekonomike.

-Databaza e brendshme, e cila përdoret vetëm nga autoritet kontraktuese për krijim njoftimesh, vleresime dhe administrim të procedurave.

Një proces sinkronizues bën të mundur sinkronizimin e këtyre databazave në kohë reale. Të tre databazat janë të konfigurara në hig availability mode me Always-On availability group.

Kjo zgjidhje teknike në lidhje me arkitekturën e të dhënave të sistemit, krijon shpërndarjen dhe eliminon ngarkesën e përdoruesve në SPE, duke mundësuar një sistem më të shpejtë, performancë me të lartë dhe krijimin e sa më pak incidente për përdoruesit.

Procedurat e prokurimit me profil të teknologjisë së informacionit për periudhën objekt auditimi:

*1. Blerje pajisje kompjuterike, UPS dhe fotokopje 2017*

Me Memo-n me nr. 11890 prot, datë 12.09.2017 drejtuar komisionit për prokurimet e vlerave të vogla, është bërë kërkesa për blerje kompjutera, si pasojë e gjendjes zero në magazinë si dhe amortizimit të atyre në përdorim.

Me Memo-n me nr. 14188 prot, datë 21.11.2017 drejtuar komisionit për prokurimet e vlerave të vogla, është bërë kërkesa për fotokopje si dhe për 4 UPS (sëbashku me 4 kompjuterat e kërkuar më parë). Bashkëlidhur me këtë MEMO janë specifikimet teknike standarde të miratuara nga AKSHI për pajisjet e kërkuara.

Përlllogaritja e fondit limit është kryer me anë të testimit të tregut. Me Memo-n me nr. 14188/4 prot, datë 22.11.2017 të Komisionit të prokurimit me vlera të vogla, kanë përcaktuar fondin limit prej 619,400 lekë pa TVSH. Komisioni është i përbërë nga Fatjon Cajupi, Klodiana Elezi dhe Ledio Kruja.

Urdhëri i prokurimit nr. 11 me nr. 14188/5 prot, datë 22.11.2017, nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i APP.

Në ftesën për ofertë me nr. 14188/6 prot, datë 22.11.2017, janë caktuar kriteret e pjesëmarrjes si dhe mënyra e furnizimit. Data e hapjes së ofertave është caktuar data 27.11.2017.

Me anë të Memo-s me nr. 14545 prot, datë 30.11.2017, është anuluar procedura e prokurimit, pasi data e hapjes së ofertave 27 nëntor, sipas VKM nr. 698, datë 23.11.2017, u shpall ditë pushimi. Në udhëzimin e APP nr. 4, datë 09.05.2017 “Për veprimet e njësisë së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Afati i fundit për pranimin e ofertave në asnjë rast nuk duhet të përkojë në ditë feste zyrtare apo në ditë pushimi*”.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Urdhëri i ri i prokurimit për këtë procedurë është me nr. 12, me nr. 14546/1 prot, datë 30.11.2017.

Në ftesën për ofertë me nr. 14543/2 prot, datë 30.11.2017, janë caktuar kriteret e pjesëmarrjes si dhe mënyra e furnizimit. Data e hapjes së ofertave është caktuar data 04.12.2017.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 28 operatorë ekonomik, ku është renditur i pari oe “” me ofertë ekonomike 390,000 lekë pa TVSH.

Me procesverbalin nr. 1 datë 04.12.2017 të mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla, ndër të tjera citohet: “...shoqëria “” është renditur në vend të parë me ofertë ekonomike 390,000 lekë. Kjo shoqëri pas vlerësimit të bërë në sistem është lajmëruar nëpërmjet menusë së mesazheve, që të paraqitej në APP në datën 05.12.2017, ora 12, për të dorëzuar dokumentat e kërkuara sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë. Ky operator ekonomik nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar, gjithashtu nuk ka dërguar ndonjë njoftim për arsyet e mosparaqitjes. Në këto kushte KVO ... vendosi që të kalojë tek ofertuesi në vend të dytë, i cili ka paraqitur ofertën e tij me vlerë në shumën prej 479,900 lekë pa TVSH”.

Me procesverbalin nr. 2 datë 05.12.2017 të mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla, ndër të tjera citohet: “...shoqëria e renditur në vend të dytë me ofertë ekonomike 479,900 lekë. Kjo shoqëri pas vlerësimit të bërë në sistem është lajmëruar nëpërmjet menusë së mesazheve, që të paraqitej në APP në datën 06.12.2017, ora 12, për të dorëzuar dokumentat e kërkuara sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë. Ky operator ekonomik nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar, ka dërguar njoftim për arsyet e mosparaqitjes, duke shprehur se: “Tërhiqem nga tenderi për arsye të llogaritjes gabim të mallit të kërkuar”. Në këto kushte KVO ... vendosi që të kalojë tek ofertuesi në vend të tretë, i cili ka paraqitur ofertën e tij me vlerë në shumën prej 506,000 lekë pa TVSH”.

Me procesverbalin nr. 3 datë 06.12.2017 të mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla, ndër të tjera citohet: “...shoqëria e renditur në vend të tretë me ofertë ekonomike 506,000 lekë. Kjo shoqëri pas vlerësimit të bërë në sistem është lajmëruar nëpërmjet menusë së mesazheve, që të paraqitej në APP në datën 07.12.2017, ora 12, për të dorëzuar dokumentat e kërkuara sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë. Ky operator ekonomik nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar, gjithashtu nuk ka dërguar ndonjë njoftim për arsyet e mosparaqitjes. Në këto kushte KVO ... vendosi që të kalojë tek ofertuesi në vend të katërt, operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën e tij me vlerë në shumën prej 525,000 lekë pa TVSH”.

Me procesverbalin nr. 4 datë 11.12.2017 të mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla, ndër të tjera citohet: “...shoqëria erenditur në vend të katërt me ofertë ekonomike 525,000 lekë. Kjo shoqëri pas vlerësimit të bërë në sistem është lajmëruar nëpërmjet menusë së mesazheve, që të paraqitej në APP në datën 07.12.2017, ora 12, për të dorëzuar dokumentat e kërkuara sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë. Ky operator ekonomik nuk u paraqit në datën dhe orën e caktuar, ka dërguar njoftim për paraqitje, edhe pse u njoftua për tu paraqitur Brenda datës 11.12.2017, ora 12:10, ky operator nuk u paraqit duke mos cilësuar shkaqet e mosparaqitjes. Në këto kushte KVO ... vendosi që të kalojë tek ofertuesi në vend të pestë,



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*operatori ekonomik i cili ka paraqitur ofertën e tij me vlerë në shumën prej 529,000 lekë pa TVSH”.*

Me procesverbalin nr. 5 datë 12.12.2017 të mbajtur nga komisioni për blerjet e vogla, ndër të tjera cilësohet se OE është paraqitur së bashku me dokumentacionin e potë, duke u shpallur fitues.

Formulari i njoftimit të fituesit është me nr. 14545/3 prot, datë 13.12.2017. Fitues me vlerë 529,000 lekë pa TVSH.

Pajisjet janë marrë në dorëzim nga ana e KVO më datë 13.12.2017.

Kontrata ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të APP dhe Shoqërisë është lidhur në datën 14.12.2017 me nr. 14545/4 prot.

Shënim: Sa më sipër, rezulton se procesverbalet e KVO janë mbajtur në një datë të caktuar, ndërkohë që në përmbajtje citohen data të mëvonshme. Nisur nga ky fakt u audituan mesazhet elektronike në faqen e APP, dhe u konstatua se kemi të bëjmë me një gabim njerëzor në vendosjen e datave në prcesverbale.

## *2. Shërbim internet për vitin kalendarik 2018*

Me Memo-n me nr 14683 prot, datë 05.12.2017, drejtuar KVO për blerjet e vogla, është kërkuar zhvillimi i procedurës së prokurimit për sigurimin e shërbimit të internetit për vitin 2018.

Me Memo-n me nr 14683/1 prot, datë 07.12.2017, drejtuar Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit, është kërkuar hartimi i specifikimeve teknike.

Me Memo-n me nr 14683/2 prot, datë 15.12.2017, janë përcaktuar specifikimet teknike për këtë procedurë.

Me Memo-n me nr 14683/6 prot, datë 15.12.2017, është caktuar fondi limit për këtë procedurë. Përlllogaritja është bërë duke marrë mesataren e tre ofertave të tregut. Më pas është bërë mesatarja e kësaj të fundit me vlerën e kontratës së mëparshme, duke konkluduar në një vlerë 222,000 lekë pa TVSH.

Urdhri i prokurimit nr. 17 me nr. 14683/7 prot, datë 19.12.2017.

Ftesa për ofertë me nr. 14683/8 prot, datë 19.12.2017, është përcaktuar data e zhvillimit 22.11.2017 ora 10:00, si dhe kërkesat për kualifikim e specifikimet teknike.

Në vend të parë janë renditur dy operatorë më të njëjtën ofertë prej 99,000 lekë pa TVSH,.

Me procesverbalin e mbajtur në datën 26.12.2017 nga KVO dhe përfaqësuesit e OE të renditur në vend të parë, është hedhur shorti për shpalljen e fituesit, ku fitues është shpallur OE X.

Kontrata është lidur në datën 03.01.2018, me nr. 14683/9 prot, ndërjmet APP të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, dhe shoqërisë .

## *3. Pajisje elektronike për sistemin IT*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Për vitin 2018, është hartuar regjistri i parashikimeve të prokurimit publik me shkresën nr. 602/1 prot, datë 15.01.2018. Ndër të tjera, procedura me objekt “Pajisje elektronike për sistemin IT” me fond limit 4,250,000 lekë, për të cilën organi qëndror blerës është AKSHI.

Me anë të Memo-s me nr. 5204/2 prot, datë 19.06.2018, është informuar Drejtori i Përgjithshëm i APP mbi nevojat e pajisjeve elektronike për sistemin IT, dhe është kërkuar nisja e procesit të prokurimit.

Me urdhër të brendshëm nr. 66 me nr. 6402 prot, datë 21.06.2018 është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për këtë procedurë.

Me Memo-n me nr. 6402/1 prot, datë 26.06.2018 i janë dërguar specifikimet teknike Drejtorit të Përgjithshëm të APP.

Me shkresën me nr. 6402/2 prot, datë 02.07.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP, drejtuar AKSHI-t, është kërkuar zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt “Pajisje elektronike për sistemin IT”.

*Deri në momentin e kryerjes së auditimit, kjo procedurë nuk ka përfunduar ende, duke vënë në rrezik ecurinë normale të punës, kryesisht lidhur me procesin e backup-it (mungesa e Tape-ve). Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk të lartë, pasi procesi i backup-t është një proces mjaft i rëndësishëm për ruajtjen periodike të të dhënave. Arsyet që kanë ndikuar në këtë vonesë, në opinionin tonë, krahas vonesave në kryerjen e procedurës nga AKSHI, të cilat grupi i auditimit për efekt të objektit të auditimit nuk mund ti auditojë, lidhen me kërkesën e vonuar të APP kundrejt AKSHI-t. Gjithashtu, edhe dy procedurat e trajtuara më sipër, janë zhvilluar në muajin dhjetor, duke rrezikuar humbjen e fondeve të vitin ushtrimor në rast anulimi/shtyrjeje të përkohshme të procedurave.*

*Grupi i auditimit shpreh opinionin se procedurat e prokurimit, sidomos ato që lidhen me procese të rëndësishme të ecurisë së punës, duhet të nisin sa më shpejtë gjatë vitit, duke mos rrezikuar gjendjen në situata të paparashikuara.*

*Nisur nga eksperiencia e grupit të auditimit si dhe gabimit të konstatuar në procedurën e mësipërme “Blerje pajisje kompjuterike, UPS dhe fotokopje 2017”, konstatohet se, për arsye të ndryshme, ka mjaft raste ku ana shkruese nuk përputhet me atë elektronike. Gjithashtu mbajtja e dokumentave shkruesor, pa i bërë pjesë të dosjes elektronike të procedurave të prokurimit, rrit riskun e tjetërsimit të tyre me kalimin e kohës. Grupi i auditimit vlerëson se është e nevojshme përditësimi i faqes së APP, duke krijuar mundësinë e hedhjes apo ngarkimit të të gjithë dokumentacionit të procedurave të prokurimit, duke rritur besueshmërinë e gjurmës së auditimit të këtyre procedurave.*

*Në përgjigje të observacioneve mbi aktkonstatimin nr. 4, të dërguara nga APP me shkresën përcjellëse nr. 9168/1 prot, datë 15.10.2018 (APP), dhe protokolluar në KLSH me nr. 865/3 prot, datë 18.10.2018, sqarojmë se:*

*Në lidhje me konstatimin e gabimeve të bëra në procesverbalet e mbajtura, nga APP konfirmohet e njëjta gjë e cila është shprehur nga grupi i auditimit, që kemi të bëjmë me një gabim njerëzor, pasi ajo që e vërteton këtë është gjurma e auditimit në SPE. Pikërisht për këtë*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

*arsye grupi i auditimit është i mendimit që duhet të shtohen dokumentat të cilat duhet të ngarkohen në SPE. Mqns nga ana e APP është trajtuar fakti i hapësirave që do të ziheshin nga ngarkimi i procesverbaleve, ndoshta kjo do të mund të zgjidhej me plotësimin e fushave, dhe jo ngarkimeve të dokumenteve, çka do të kërkonte më pak hapësirë. Megjithatë të dyja variantet duhet të analizohen nga ana e APP duke aplikuar variantin më të mirë të mundshëm.*

*Në lidhje me observacionin mbi konstatimin e grupit të auditimit për nisjen e procedurave të prokurimit në fillim të vitit, duke paraprirë riskun e vonesave që mund të hasen, sqarojmë se ky konstatim është trajtuar më së shumti si një risk i përgjithshëm që ka marrë indicie nga procedurat e audituara, dhe jemi të opinionit që fillimi i procedurave të prokurimit sa më shpejtë e ul këtë risk. Fakti që është marrë shkas nga këto procedura nuk do të thotë që problemi janë pikërisht këto procedura. Konstatimi është kryer më së shumti në riksun që mbart fillimi me vonesë i procedurave. Theksojmë këtu procedurën me objekt “Pajisje elektronike për sistemin e IT” që po kryhet nga AKSHI, trajtuar në material.*

**Titulli i gjetjes:** Vonesë në fillimin e procedurave.

**Situata:** Deri në momentin e kryerjes së auditimit, procedura e prokurimit “Pajisje elektronike për sistemin IT”, e cila pritet të finalizohet nga AKSHI, nuk ka përfunduar ende, duke vënë në rrezik ecurinë normale të punës, kryesisht lidhur me procesin e backup-it (mungesa e Tape-ve). Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk të lartë, pasi procesi i backup-t është një proces mjaft i rëndësishëm për ruajtjen periodike të të dhënave. Arsyet që kanë ndikuar në këtë vonesë, në opinionin tonë, krahas vonesave në kryerjen e procedurës nga AKSHI, të cilat grupi i auditimit për efekt të objektit të auditimit nuk mund ti auditojë, lidhen me kërkesën e vonuar të APP kundrejt AKSHI-t. Gjithashtu, edhe procedurat tjera të trajtuara nga grupi i auditimit, janë zhvilluar në muajin dhjetor, duke rrezikuar humbjen e fondeve të vitin ushtrimor në rast anulimi/shtyrjeje të përkohshme të procedurave.

Grupi i auditimit shpreh opinionin se procedurat e prokurimit, sidomos ato që lidhen me procese të rëndësishme të ecurisë së punës, duhet të nisin sa më shpejtë gjatë vitit, duke mos rrezikuar gjendjen në situata të paparashikuara

**Ndikimi/efekti:** Risk për mungesë të burimeve të nevojshme për ecurinë normale të punës.

**Shkaku:** Fillim me vonesë i procedurave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Në vazhdimësi APP të marrë masa që procedurat e prokurimit, sidomos ato që lidhen me procese të rëndësishme të ecurisë së punës, të nisin sa më shpejtë gjatë vitit, duke mos rrezikuar gjendjen në situata të paparashikuara.

**Titulli i gjetjes:** Ekzistenca e të gjithë dokumentacionit të tenderit në formë elektronike.

**Situata:** Nisur nga eksperiencia e grupit të auditimit si dhe gabimit të konstaur në procedurën e mësipërme “Blerje pajisje kompjuterike, UPS dhe fotokopje 2017”, për arsye të ndryshme, ka mjaft raste ku ana shkruese nuk përputhet me atë elektronike. Gjithashtu mbajtja e dokumentave shkruesor, pa i bërë pjesë të dosjes elektronike të procedurave të prokurimit, rrit riskun e tjetërsimit të tyre me kalimin e kohës. Grupi i auditimit vlerëson se është e nevojshme përditësimi i faqes së APP, duke krijuar mundësinë e hedhjes apo ngarkimit të të gjithë



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

dokumentacionit të procedurave të prokurimit, duke rritur besueshmërinë e gjurmës së auditimit të këtyre procedurave.

**Ndikimi/efekti:** Pasaktësi në dokumentacionin fizik apo tjetërsim të tyre.

**Shkaku:-**


**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** APP të shqyrtojë mundësinë e shtimit të opsionit të hedhjes së të gjithë dokumentacionit të tenderit me qëllim rritjen e besueshmërisë në procedurat e prokurimit duke e plotësuar elektronikisht të gjithë gjurmën e auditimit.

**Pika 3. “Auditimi i sigurisë së informacionit”**

***a. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK***

Një menaxhim risku kërkon në mënyrë të vazhdueshme të identifikohet, të monitorohet dhe të përmirësohet duke ndjekur ciklin si në skemën e mëposhtme:



APP ka identifikuar dhe ka dokumentuar si pjesë të regjistrit të riskut dhe risqe që i përkasin teknologjisë dhe përdorimit e saj si më poshtë:

Për vitin 2017:

1. Blerje pajisje hardware për Sistemin e Prokurimit Elektronik
2. Mirëmbajtja e Sistemit të Prokurimit Elektronik
3. Përmirësim i shërbimeve funksionale të IT dhe kushteve të punës për punonjësit

Për vitin 2018:

1. Blerje pajisje hardware për Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe sistemin e Arkivës
2. Mirëmbajtja e Sistemit të Prokurimit Elektronik
3. Përmirësim i shërbimeve funksionale të TIK dhe kushteve të punës për punonjësit



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

4. Shpenzime mirëmbajtje rrjeti elektrik, pajisje kompjuterike, printera, rrjeti kompjuterik, objekti, etj.

Risqet e identifikuar nga APP në të dy vitet, kanë të bëjnë vetëm me: mosgarantimin e buxhetit të nevojshëm dhe mosparaqitjen e ofertave.

**Nga auditimi mbi identifikimin e risqeve në teknologjinë e informacionit rezulton se janë identifikuar të njëjtat fusha të përsëritura, ku objektivat janë të përgjithshme dhe pothuajse të njëjtë në dy 2 vitet 2017 dhe 2018.**

**Nga auditimi mbi prioritarizimin dhe probabilitetin rezulton se risqet e dokumentuara në mënyrë të përsëritur me probabilitet dhe rëndësi të njëjtë, janë në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.**

Njëkohësisht, për vitin 2018, **nuk rezulton të jetë përditësuar regjistri me risqe të reja** që vijnë natyrshëm si rezultat i ndryshimeve në organikë që ka patur dhe do të ketë institucioni, ku sipas VKM nr. 603, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, do të jetë administrues i infrastrukturës dhe sistemit elektronik të prokurimit, ndërsa sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar “Për prokurimin publik”, APP është administrues për procesin e prokurimit e njëkohësisht sistemin elektronik në të cilin ky proces është pasqyruar, duke përfshirë dhe të dhënat që gjenerohen prej tij.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 2, datë 08.10.2018, për të cilin nga ana e subjektit është observuar me anë të shkresës nr. 9168/1, datë 15.10.2018, në lidhje me:*

*I. Risqet e mundshme që lidhen me plotësimin e të dhënave mbi procedurat e parashikuara nga autoritetet kontraktore, për të cilat sqarojmë se vënia në dispozicion e manualeve dhe udhëzuesve nuk mjafton për të garantuar të dhëna të sakta dhe të kuruara për tu përdorur më saktë në vendimarrje. Nevoja për suport është gjithashtu një element që tregon se manuallet dhe udhëzuesit nuk mjaftojnë.*

*II. Nuk janë analizuar dhe identifikuar mbivendosjet ligjore në lidhje me të drejtat dhe detyrimet, si dhe hapat që do të ndërmerren për minimizimin e problemeve që mund të ndodhin në sistemin e prokurimit, ndërmjet AKSHI-t dhe APP, sqarojmë se grupi i auditimit me mbivendosje ligjore e ka fjalën për administrimin e sistemit të prokurimit, për të cilat APP është përgjegjëse prej Ligjit të saj dhe AKSHI është përgjegjës prej VKM nr.673. Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim, për arsyen se sheh praninë e një risku shumë të lartë që vjen në mënyrë të pashmangshme në administrimin e sistemit por sidomos të të dhënave. APP nuk ka identifikuar asnjë risk në lidhje me këtë ndryshim, nuk ka identifikuar as elementë apo procedura kontrolli mbi institucionin që do të ofrojë platformën, e mbi të cilën APP nga të dhënat që do të ruhen në këtë sistem do të marrë vendimet.*

**Titulli i gjetjes:** Identifikimi i risqeve në TIK

**Situata:** Nga auditimi mbi risqet në TIK, rezultoi se:



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

-Risqet e identifikuara për vitin 2017 si dhe prioriteti dhe probabiliteti janë të njëjta me 3 risqet e identifikuara në vitin 2018, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

-Në të dy regjistrat e viteve 2017 dhe 2018 nuk rezulton që gjatë vitit të ketë patur përditësime me risqe të reja të identifikuara gjatë periudhës.

-Nuk janë analizuar dhe dokumentuar si pjesë e regjistrat të riskut hapat që duhen ndërmarrë nga specialistët e TIK, për minimizimin e çdo risku të identifikuar për teknologjinë e informacionit.

- Nuk janë identifikuar risqe në lidhje me: *sigurinë, disponibilitetin dhe integritetin e sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet sistemit të prokurimit publik* si dhe palët e treta që janë kontraktuar për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të prokurimit elektronik dhe fizik.

-Nuk janë identifikuar risqe të mundshme që lidhen me plotësimin e saktë të të dhënave për procedurat e parashikuara nga autoritet kontraktore, për tu zhvilluar në vitin kalendarik, proces ky i cili është informatizuar dhe ka përfunduar fazën e testimit.

-Nuk janë identifikuar risqet në burimet njerëzore të TIK, të cilat duhen adresuar për të siguruar mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të prokurimit.

-Ndarja ose transferimi i risqeve së bashku me asetet tek AKSHI, dhe për cilat risqe ndjekja dhe minimizimi i tyre do të administrohen nga APP.

-Nuk janë analizuar dhe identifikuar mbivendosjet ligjore, si dhe hapat që do të ndërmerren për minimizimin e problemeve që mund të ndodhin në sistemin e prokurimit si dhe përgjegjësitë ndërmjet e AKSHI-t dhe APP.

-Nuk janë identifikuar rrisqe që lidhen me hapa të procedurës së prokurimit që janë ende të painformatizuar për përmirësim të sistemit të prokurimit si prsh, të dhënat që lidhen me nënkontraktimin të cilin autoritet kontraktore aktualisht e administrojnë në letër.

**Ndikimi/efekti:** Mos identifikim i saktë i risqeve në TIK, ben të pamundur vendosjen e prioriteteve dhe përgjegjësi në funksion të minimizimit të tij.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** APP me transferimin e aseteve dhe burimeve njerëzore te AKSHI, në bashkpunim me këtë të fundit të analizojë dhe të konsiderojë risqet që lidhen me Teknologjinë duke bërë një ndarje sa më reale midis atyre që do të administroje vetë dhe atyre që për shkaqe teknike i delegohen AKSHI-t. Te dokumentohen përgjegjësit dhe hapat që duhen ndjekur për cdo risk të identifikuar. APP të përditësojë regjistrin me risqe të reja të identifikuara gjatë periudhës dhe të mbajë në monitorim të vazhdueshëm ecurinë e risqeve, ku theksi duhet të jetë në garantimin e sigurisë, disponibilitetit dhe integritetit të sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi i prokurimit publik.



### **Kodet e kategorisë së produktit**

Regjistri i parashikimit në fillim të vitit 2018 është tërësisht i populluar, ku përveç emërimit të procedurës dhe vlerës, janë bërë të detyrueshme afati i zhvillimit të procedurës dhe kodi CPV<sup>8</sup> që tregon kategorinë në të cilën klasifikohet produkti që do të prokurohet. Nga analiza e të dhënave që morri grupi i auditimit, në shumë raste në regjistrin e parashikimit nuk specifikohet kodi i procedurës, duke zgjedhur kodin 000000, ku për vitin 2018, rezultojnë të jenë 294 procedura me vlerë mbi 8 milion dhe në 703 procedura me vlerë nën 8 milion të cilat nuk kanë informacion se çfarë kanë parashikuar të prokurojnë.

Autoriteteve kontraktore duhet t'ju hiqet mundësia e Zgjedhjes së kodit 000000, në mënyrë që APP të përfitojë raporte sa më të sakta statistikore çfarë lehtëson dhe daljen në konkluzione për vendimarrje të APP.

**Titulli i gjetjes:** Kodet e kategorisë së produktit

**Situata:** Nga auditimi rezulton se lista e kodeve edhe pse është konfiguruar dhe plotësimi në sistem është bërë i detyrueshëm, në web nuk është publikuar, për ti dhënë mundësi autoriteteve kontraktore që të studjojnë listën e kategorive, përpara plotësimit të saj. **Ndikimi/efekti:**

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** APP të marrë masa për Informimin e AK me listën e kodeve CPV që përcaktojnë saktë kategorinë e produktit. Njëkohësisht APP të bëjë ndryshimet e nevojshme në listën e kategorive të produktit duke hequr nga mundësia e zgjedhjes kodin 000000 si dhe të garantojë suportin për ndryshime apo shtime në listën e kategorive.

### **Pika 4. “Auditimi i Aplikacioneve”.**

#### ***a. Verifikimi i shkallës së sigurisë së aplikacioneve***

Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet qeveritare, kjo si pasojë rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmëria. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe*

<sup>8</sup> Common Procurement Vocabulary



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria”.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

*Verifikim i strategjisë së TI dhe lidhja me objektivat e veprimtarisë së institucionit*

Agjencia e Prokurimit Publik në vijim (APP) është institucion në varësi të Kryeministrit. Veprimtaria e saj bazohet në ligjin nr. 9643/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe ligjin nr. 9874/2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar.

Detyrat dhe kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik fokusohen kryesisht në:

-Përgatitjen e projekt-propozimeve për rregullat e prokurimit publik, ankandeve publike dhe atyre në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, hartimin e Dokumentave Standarte të Tenderit dhe nxjerrja e udhëzimeve të nevojshme në ndihmë të autoriteteve që ndërmarrin këto procedura;

-Verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik, procedurave të koncesionit dhe ankandit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës dhe në rast shkeljesh të dispozitave ligjore dhe nënligjore, vendosjen e gjobave ose propozimin e marrjes së masave administrative;

-Monitorimin e mbarëvajtjes së sistemit të prokurimit publik, si dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve në mënyrë që të arrijë dhe të ruajë një sistem plotësisht transparent dhe efikas të koncesioneve/partneriteteve publike private;

-Hartimin dhe nxjerrjen e Buletinit të Njoftimeve Publike;

-Përfshirjen e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionare apo të ankandit publik për një periudhë nga një deri në tre vjet;

-Nxitjen dhe organizimin e kualifikimit të punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;

*Verifikim i rregulloreve, politikave dhe procedurave e TIK*

Me qëllim auditimin e nivelit të administrimit të dokumentimit, të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në APP, grupi i auditimit verifikoi dokumentacionin si në vijim “Për miratimin e rregullores së brendshme të institucionit të APP”, “Planin e sigurisë” si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikat me të cilat institucioni punon.

APP me dokumentin me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017 ka hartuar Planin e Sigurisë të Rishikuar, ku janë përcaktuar ndër të tjera parimet dhe rregullat e sigurisë, qëllimi dhe fusha e zbatimit, objektivat e sigurisë, përgjegjësitë mbi sigurinë dhe klasifikimi i aseteve të informacionit, siguria e personelit, siguria fizike dhe e mjedisore, administrimi i sistemeve të informacionit, kontrolli i aksesit, administrimi i vazhdueshmërisë së aktivitetit.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Nisur nga rëndësia që sistemet e informacionit kanë për realizimin e procedurave të prokurimit publik në mbarë Republikën e Shqipërisë, APP ka hartuar dhe miratuar:

- Me Vendim Nr. 14, datë 13.09.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP është miratuar rregullorja e brendshme “Për miratimin e rregullores së brendshme të institucionit të APP”.
- Rregullorja e Teknologjisë së Informacionit është pjesë e planit të sigurisë të miratuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP.
- Me Vendim Nr. 8, datë 12.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP, është miratuar rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në Agjencinë e Prokurimit Publik”.
- Me Vendim Nr. 9, datë 12.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP, është miratuar dokumenti “Për miratimin e gjurmëve të auditimit”.
- Me Vendim Nr. 10, datë 19.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP, është miratuar rregullorja e brendshme “Për procedurat e përjashtimit nga pjesëmarrja në prokurimet publike, koncesionet/partneritetin publik provat dhe ankandet publike”.
- Me Vendim Nr. 11, datë 19.01.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të APP, është miratuar rregullorja e brendshme “Për procedurat e monitorimit”.

Inventar i të dhënave, programeve aplikative dhe pajisjeve me ofruesin e shërbimit, mbahet nëpërmjet një regjistri fizik si dhe në librat e gjendjes së magazinës së APP.

Plani i sigurisë për ndërtesën ku ndodhen backup, duke qenë se APP ndodhet brenda godinës së Kryemnistisë, është pjesë e planit të sigurisë së gardës të cilin APP nuk e disponon. Nga informacioni i marrë, konstatohet se nuk ka patur asnjëherë incidente në lidhje me çështjet e sigurisë.

Nga ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes janë mbajtur raporte mujore mbi shërbimet dhe testimet fizike të kryera gjatë gjithë periudhës prill 2017 – aktualisht.

*APP disponon politika të shkruara mbi vazhdimësinë e punës (business continuity), si dhe politika të shkruara mbi rimëkëmbjet nga katastrofat (disaster recovery). Nga auditimi u konstatua se APP nuk disponon dokumentacion për ngritjen e grupit të punës apo të testeve zhvilluara për funksionimin e këtyre dy politikave mjaft të rëndësishme për sistemin e APP, në kundërshtim me pikën 9.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017. Këto teste duhet të kryhen në mënyrë periodike dhe me theks të lartë sa herë të ketë ndryshime thelbësore, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se sistemi do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohur me zbatimin e hapave që duhen ndjekur. Për këtë arsye grupi i auditimit shprehet me rezervë mbi funksionimin apo jo të dy politikave të mësipërme mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjen nga katastrofat, në rast se do të jetë e nevojshme.*

Verifikimi i dokumentimit të planeve të vazhdueshmërisë së institucionit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

Auditimi mbi Planin e Vazhdueshmërisë së Biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, risqeve të identifikuara dhe praktikave më të mira. Referuar sa më sipër, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të realizojë investime për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave.

*Nga auditimi u konstatua se nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik janë hartuar “Plan për rimëkëmbjen nga katastrofa, si dhe “Politika të vazhdueshmërisë së punës”. Grupi i auditimit vlerëson këto dokumenta të rëndësishëm për vazhdimësinë dhe rimëkëmbjen e punës, por për materializimin apo vënien në mjedis testi të efikasitetit apo jo të këtyre dy planveprimeve nuk ka dokumentacion. Pra këto planveprime ekzistojnë, por nuk janë testuar nëse do të ishin të realizueshme dhe të efektshme.*

*Gjithashtu, referuar pikës nr. 9.3 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017, këto plane duhet të rishikohen të paktën një herë në vit, veprim i cili rezulton të mos jetë përmbushur pasi plani i fundit i rekuperimit nga katastrofa i vënë në dispozicion të grupit të auditimit është me datë 07.04.2017.*

#### Portali Web i APP

Për testimin e performancës së faqes së internetit u bënë disa pen test për sjelljen e faqes Web sipas browserit të zgjedhur. Kjo metodë përdoret për gjetjen e gabimeve siç është “404’s”, “malware” ose probleme më komplekse siç janë burimet e jashtme që bllokojnë pasqyrimin e faqes (*page rendering*) dhe rezultoi si më poshtë:

*Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurtë (connection security) HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) (Not secure status) që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie e cila vërteton identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm. Në mungesë të kësaj certifikate, ekziston risku për humbjen e privatësisë apo ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali.*

*Grupi i auditimit e testoi faqen e APP në disa “free page security test”, nga ku rezultuan mjaft raste ku shfaqeshin “malware” si dhe pika të dobëta dhe jo të sigurta të faqes. Për arsye sigurie dhe konfidencialiteti, grupi i auditimit nuk do ti bëjë pjesë të materialit, por do ti komunikojë ato me stafin përgjegjës të APP.*

#### Procedura e backup dhe menaxhimi i asetëve

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

Strategjia e APP për krijimin e backupëve të sistemit dhe sigurimin e aksesueshmërisë së lartë të të dhënave është e bazuar mbi backupet FULL, Diferencial dhe backupëve të Transaction Log.

Procesi i krijimit të backupëve është automatizuar në mënyrë të tillë që backupet FULL të krijohen një herë në javë, backupet diferencial të krijohen çdo ditë dhe backupet e logeve të krijohen çdo 15 min. Në këtë mënyrë mund të sigurohet humbje minimale e të dhënave në rast të një fatkeqësie, deri në 15 min e fundit.

Është krijuar një database e veçantë e quajtur "Maintenance" në të njëjtën instancë të SQL Server, në të dy nyjet e availability group. Brenda kësaj database ka procedura dhe tabela të përdorura për veprime të ndryshme mirëmbajtje të cilat kryhen në mënyrë automatike nga sistemi.

Procedura ekzekutohet nga SQL Server Agent CmdExec jobs, duke përdorur sqlcmd dhe optionin -b kalohen parametrat e procedurës sipas emrit:

```
sqlcmd -E -S $(ESCAPE_QUOTE(SRVR)) -d master -Q "EXECUTE dbo.DatabaseBackup @Databases = 'USER_DATABASES', @Directory = 'C:\Backup', @BackupType = 'FULL'" -b
```

Përdoret SQL Server output files për të siguruar që është i gjithë informacioni i plotë i nevojshëm në rast të një errorit.

Krijimi i shpeshtë i backupëve është shumë i rëndësishëm për shmangien e humbjes së të dhënave në rast fatkeqësie, por nuk është gjithçka që duhet bërë për të qënë 100% të sigurt. Shpesh skedaret e backup-it mund korruptohen për arsye të ndryshme dhe nuk janë në gjendje të bëhen restore në asnjë ambient. Në rast të një fatkeqësie, nëse ka një situatë ku i vetmi backup që zotërohet është i korruptuar, pasojat do të ishin shkatërruese.

Në mënyrë që të shmanget kjo, duhet që të performohen kontrole të rregullta të integritetit të backupëve. Nga APP, kjo realizohet duke kryer restore të backupëve që janë krijuar dhe më pas duke ekzekutuar komandën DBCC CHECKDB. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një siguri e lartë për përgatitjen në rast fatkeqësie.

Kasetat ku ruhen backup-et, magazinohen në kasafortë dhe kasaforta përmban kodin e sigurisë dhe dy çelsa të cilat kanë mbajtës të ndryshëm. Kasaforta është ndërtuar në mënyrë të tillë që mungesa e njërit prej mjeteve (çelsi ose kodi i sigurisë) të sjellë në mosfunksionimin e saj. Hapja e kasafortës behet në prezente të dy personave.

#### ***Proceset e përhershme në prapaskenë dhe skedulimi i punëve.***

Punët (SQL Jobs) janë konfiguruar në të dy nyjet e SQL Server. Për tu lidhur nëpërmjet Management Studio dhe të aksesohen përdoret:

IP: 172.24.39.11 & 172.24.39.12

-Sinkronizimi i procedurave të reja nga sistemi i brendshëm drejt atij publik.

Vendndodhja:

Jobi mund të aksesohet në seksionin SQL Agent, brenda Management Studio. Emri i job-it është



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

“*Synchronization\_Internal\_To\_Efiling\_New*”. Hapat e këtij job-i kryejnë ekzekutimin e disa paketave SSIS, të cilat mund të gjenden brenda të njëjtit server në driven C:\. Path-i i plotë është: C:\SSIS\_Packages\MIGRATION\_ARCHIVE .

Skeduli:

Ky job është skedular të ekzekutohet çdo 2 min. Kjo mund të ndryshohet.

Nr	Emri	Pershkrimi
1	Exec RefData	Ky hap ekzekuton paketën INT_2_EF_Users_N_RefData.dtsx e cila ben sinkronizimin e te dhenave reference nga sistemi I brendshem drejt sistemit publik.
2	Exec Package	Ky hap ekzekuton paketën INT_2_EF.dtsx e cila ben sinkronizimin e procedurave te reja nga sistemi I brendshem drejt sistemit publik.

-Sinkronizimi i ofertave nga sistemi publik drejt sistemit të brendshëm.

Vendndodhja:

Job-i mund të aksesohet në seksionin SQL Agent, brenda Management Studio. Emri i job-it është “*Synchronization\_Efiling\_To\_Internal*”. Hapat e këtij job-i kryejnë ekzekutimin e disa paketave SSIS, të cilat mund të gjenden brenda të njëjtit server në driven C:\. Path-i i plotë është: C:\SSIS\_Packages\MIGRATION\_ARCHIVE.

Skeduli:

Ky job është skedular të ekzekutohet çdo 2 min. Kjo mund të ndryshohet.

Hapat që përfshin: Nr	Emri	Pershkrimi
1	Exec Package	Ky hap ekzekuton paketën EF_2_INT.dtsx e cila ben sinkronizimin e te dhenave te ofertave nga sistemi public drejt sistemit te brendshem.

-Sinkronizimi i procedurave ekzistuese nga sistemi i brendshëm drejt atij publik.

Vendodhja:

Job-i mund të aksesohet në seksionin SQL Agent, brenda Management Studio. Emri i job-it është “*Synchronization\_Internal\_To\_Efiling\_Updates*”. Hapat e këtij job-i kryejnë ekzekutimin e disa paketave SSIS, të cilat mund të gjenden brenda të njëjtit server në driven C:\. Path-i i plotë është: C:\SSIS\_Packages\MIGRATION\_ARCHIVE

Skeduli:

Ky job është skedular të ekzekutohet çdo 5 min. Kjo mund të ndryshohet.

Hapat që përfshin: Nr	Emri	Pershkrimi
1	Exec Package	Ky hap ekzekuton paketën INT_2_EF_Update.dtsx e cila ben sinkronizimin e te dhenave te ofertave nga sistemi public drejt sistemit te brendshem.

*Instalimi i sistemeve dhe moduleve në rast katastrofash*

Krijimi i përdoruesve të nevojshem për ngritjen e sistemit

- Përdorues për aplikimin e brendshëm EPS\_CORE (SvcAppInternal)
- Përdorues për aplikimin publik të ofertimit EPS\_EFILING (SvcAppPublic)



## KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

- Përdorues për aplikimin e portalit publik EPS\_PORTAL (SvcAppPortal)
- Përdorues për aksesimin e raporteve (SvcReports)
- Përdorues për aksesimin e të dhënave nga paketat e sinkronizimit (SvcSSIS)

Nevojiten disa përdorues për të konfiguruar si service accounts. Konkretisht:

Nëse ambjenti ku do të ngrihet sistemi është pjesë e një domain, përdoruesit do të krijohen në domain controllerin e active direktorisë. Nëse sistemi do të ngrihet në një makine të vetme, mund të krijohen si usera lokal windowsi.

#### *Ngritja e databazës*

Baza e të dhënave të sistemit është zhvilluar mbi SQL Server 2016. Në mënyrë që të bëhet restore, një instance e tij duhet të jetë e instaluar. Në ambientin Production janë konfiguruar dy instanca të pavarura SQL Server me hapësirë storage të veçantë.

Nyja 1 SQL: 172.24.39.11

Nyja 2 SQL: 172.24.39.12

Të dy instancat janë pjesë e një grupi High Availability. Grupi HA krijon një cluster logjik mbi të dyja instancat. Në këtë cluster, njëra nyje është primare dhe tjetra është replika sekondare. Cluster-i është i aksesueshem nëpërmjet një dëgjuesi (listener). Dëgjuesi është në djeni të nyjes primare dhe ridrejton kërkesat drejt saj. Një avantazh i grupit high availability është që nyja sekondare mund të aksesohet për lexim të dhënash duke vendosur një atribut shtesë në connecton string (Application-Intent = 'ReadOnly'). Në këtë mënyrë moduli i raporteve do të konsumojnë të dhenat dhe nuk do të kenë impakt mbi databazën operacionale.

APP ka përcaktuar hapat që duhe të ndiqen për të ngritur sistemet në momentin që zotërohen Backup-e të bazave të të dhënave. Gjithashtu hapat për instalimin e aplikimeve, instalimin e paketave të sinkronizimit, instalimin e raporteve, etj.

#### *Rolet (user-at) në Sistemin e Prokurimit Publik*

Sistemi i Prokurimit Publik (SPE) përdor kanalet e sigurta (*https/SSL*) dhe enkriptimin për të ruajtur integritetin dhe konfidencialitetin e ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.

*a) Për autoritet akontraktore (AK) janë krijuar disa role si:*

*-Administrator i Sistemit për AK (CAAdmin), ky rol ka të drejtë të krijojë llogari përdoruesi për anëtarët e njësisë së prokurimit, të komisionit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave, auditit. Të bëjë ndryshim të fjalëkalimeve për llogaritë e përdoruesve të cilët e humbasin atë. Të bëjë mbylljen e llogarisë së përdoruesit i cili largohet nga A.K, duke zgjedhur opsionin "I Gabuar" tek fusha "Është Miratuar" por nuk ka të drejtë ta fshijë llogarinë. Kryen pezullimin e një procedure në sistem bazuar në dispozitat ligjore, dërgon për miratim elementet (zërat) e regjistrit në sistem, shënon si të realizuar elementët blerje nën 100.000 (njëqind mijë) lekë, amendamentet etj*

*-Njësia e Prokurimit (AdminOfficer) i cili është anëtari i njësisë së prokurimit dhe ka të drejtë të krijojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen hap pas hapi të procedurave të prokurimit publik në SPE në*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

zbatim të LPP. Anëtari i Njësisë së Prokurimit mund të bëjë modifikim mbi procedurat e pezulluara (të shtojë (ngarkojë) dokumenta, të ndryshojë afatin e zhvillimit të procedurës) apo të anullojë një procedure por nuk mund të fshijë asnjë të dhënë të procedurës së publikuar etj

*-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (ProcurementOfficer)* i cili është anetari i Komisionit të Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave ka të drejtë të bëjë hapjen dhe vlerësimin e ofertave vetëm pasi të ketë kaluar afati i fundit i pritjes së ofertave të percaktuar në sistem. Bën vlerësimin e ofertave të paraqitura, nuk mund të bëjë asnjë ndryshim apo fshirje të të dhënave etj

*-Auditues (CaAuditor)*, i cili është roli për anëtarët e komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe auditit, kanë të drejtë të shikojnë menyrën e krijimit të një procedure në sistem nga anëtarët e njësisë së prokurimit, të shikojnë ofertat vetëm në rastin kur faza e vlerësimit është mbyllur në sistem. Nuk mund të bëjnë asnjë ndryshim të procedure apo fshirje etj

*b) Roli për Operatorët ekonomike (Economic Operator)* është roli i Operatorëve ekonomike, të cilët mund të logohen në SPE me anë të NIPT-it të tyre. Kanë të drejtë të krijojnë ofertë ekonomike në një procedurë deri në afatin e fundit të pritjes së ofertave të percaktuar në sistem, të bëjnë kërkesa për sqarim në sistem, të dërgojnë apo të marrin mesazhe nga AK etj

*c) Roli i Audituesit* në sistem, i cili është krijuar për institucionet si Komisioni i Prokurimit Publik etj ka të drejta monitorimi të procedurave të krijuara nga autoritet kontraktore pas përfundimit të afatit anikimor për vlerësimin e ofertave pranë autoritetit kontraktor, për çdo fazë të mbyllur të procedurës. Për ankesat në lidhje me kriteret e kualifikimit para hapjes së ofertave sistemi, për rolin e KPP gjeneron një raport mbi procedurat e prokurimit për menyrën e krijimit të procedurës në sistem nga nëpunësi i autorizuar i njësisë së prokurimit. Audituesit, kanë të drejta vetëm leximi në sistem, nuk mund të fshijnë apo të bëjnë ndryshime në procedurat e krijuara në sistem.

*d) Roli i Publikuesit* në sistem është zyrtari pranë APP-së i cili bën publikimin ose pezullimin e njoftimeve të procedurave, njoftim fituesit dhe njoftimeve të kontratave të nënshkruara që të hidhen në sistem nga anëtarët e njësisë së prokurimit pranë çdo autoriteti kontraktor. Nuk bën fshirje apo ndryshim të të dhënave të njoftimeve të krijuara.

*e) Roli i Administratorit* në sistem ka të drejta monitorimi mbi procedurat që krijohen nga të gjithë autoritet kontraktore, bën support teknik për të gjithë përdoruesit e SPE. Siguron mbarëvatjen e funksionimit të SPE etj.

*Nga auditimi u konstatua se nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-punonjës i APP. Përdoruesit dhe të drejtat e tyre përcaktohen rast pas rasti, në varësi të burimeve njerëzore dhe të volumit të punës duke krijuar një risk potencial të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve, në kundërshtim me pikën 3.2.2.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.*

*Gjithashtu, çdo Autoritet Kontraktor ka në dispozicion një llogari administratori me anë të së cilës krijon llogari me rolin përkatës sipas nevojave të institucionit për të aksesuar në sistemin e APP. Nga auditimi u konstatua se hapja e këtyre përdoruesve mbetet pothuajse e pamonitoruar,*



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*pasi vetë APP nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre.*

*Në përgjigje të observacioneve mbi aktkonstatimin nr. 5, të dërguara nga APP me shkresën përcjellëse nr. 9168/1 prot, datë 15.10.2018 (APP), dhe protokolluar në KLSH me nr. 865/3 prot, datë 18.10.2018, sqarojmë se:*

*Testimi i politikave për vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjes nga katastrofat, duke mirëkuptuar ngarkesën e APP, krahas përcaktimit në Planin e Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017, nga grupi i auditimit konsiderohet e domosdoshme për dhënien e një sigurie të arsyeshme se këto plane do të funksionojnë në raste katastrofash apo avarije. Ekzistenca vetëm në letër e këtyre planeve, i bën ato të duken formale.*

*Në lidhje me rishikimin e planeve të paktën një herë në vit, APP është shprehur se do të rishikohet pasi të përcaktohen detyrat e përgjegjësitë ndërmjet APP dhe AKSHI-t në lidhje me SPE. Grupi i auditimit është dakord me këtë mendim, dhe do ta reflektojë tek afatet e rekomandimeve.*

*Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e certifikatës SSL, grupi i auditimit e vlerëson atë si një siguri më shumë për portalin e APP.*

*Për sa i përket mungesës së një rregulloreje apo dokumenti tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-punonjës, grupi i auditimit është shprehur në lidhje me punonjësit e APP. Mungesa e kësaj rregulloreje ka risk për akumulim përgjegjësish, e cila është në kundërshtim me Planin e Sigurisë së Rishikuar.*

*Për sa i përket monitorimit të llogarive të krijuara nga ana e autoritetet kontraktore, grupi i auditimit e vlerëson APP si të vetmin insitucion të përshtatshëm për kontrollin e këtyre llogarive të krijuara, pasi ka akses në sistem, ndërsa çdo institucion tjetër do të limitohet tek dokumentacioni shkresor, veprim i cili do të ishte i pamjafueshëm për qëllimin e këtij monitorimi.*

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e elementëve të sigurisë përgjatë navigimit.

**Situata:**Portali i APP nuk përdor një lidhje të sigurtë (*connection security*) HTTPS (*HyperText Transfer Protocol Secure*) (*Not secure status*) që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm. Në mungesë të kësaj certifikate ekziston risku për humbjen e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali.

**Ndikimi/efekti:** Humbja e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të portalit.

**Shkaku:-**

**Kriteri:** Siguria e faqes WEB.

**Rëndësia:**E mesme.

**Rekomandimi:** APP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes Web, të marrin masa për përmirësimin e faqes Web me elementët përkatës të sigurisë (*certifikatën e sigurisë*) së navigimit online për të rritur sigurinë dhe ndihmesën ndaj përdoruesve.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e kryerjes së testimit dhe azhurnimit së planit mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat.

**Situata:** APP disponon politika të shkruara mbi vazhdimësinë e punës (business continuity), si dhe politika të shkruara mbi rimëkëmbjet nga katastrofat (disaster recovery). Nga auditimi u konstatua se APP nuk disponon dokumentacion për ngritjen e grupit të punës apo të testimeve zhvilluara për funksionimin e këtyre dy politikave mjaft të rëndësishme për sistemin e APP, në kundërshtim me pikën 9.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017. Këto teste duhet të kryhen në mënyrë periodike dhe me theks të lartë sa herë të ketë ndryshime thelbësore, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se sistemi do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur. Për këtë arsye grupi i auditimit shprehet me rezervë mbi funksionimin apo jo të dy politikave të mësipërme mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjen nga katastrofat, në rast se do të jetë e nevojshme.

Gjithashtu plani i fundit i rekuperimit nga katastrofa i vënë në dispozicion të grupit të auditimit është me datë 07.04.2017, në kundërshtim me pikën nr. 9.3 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017, sipas së cilës këto plane duhet të rishikohen të paktën një herë në vit.

**Ndikimi/efekti:** Siguri e kufizuar mbi efektivitetin e politikave të shkruara.

**Kriteri:** Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga APP të merren masat e nevojshme për testimin e politikave mbi vazhdimësinë e punës (business continuity) dhe mbi rimëkëmbjen nga katastrofat (disaster recovery) sa herë që ato azhurnohen apo ndryshojnë, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur.

Nga APP të merren masat e nevojshme për përditësimin e planeve të rimëkëmbjes nga katastrofat dhe vazhdimësisë së punës të paktën një herë në vit me qëllim të qenurit gjithnjë në koherent me ndryshimet e ndodhura, në përputhje me Planin e Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

**Titulli i gjetjes:** Teste të sigurisë.

**Situata:** Grupi i auditimit e testoi faqen e APP në disa “free page security test”, nga ku rezultuan mjaft raste ku shfaqeshin “malware” si dhe pika të dobëta dhe jo të sigurta të faqes. Për arsye sigurie dhe konfidencialiteti, grupi i auditimit nuk do ti bëjë pjesë të materialit, por do ti komunikojë ato me stafin përgjegjës të APP.

**Ndikimi/efekti:** Ekzistenca e pikave të dobëta të faqes Web.

**Kriteri:** Faqe ndërkombëtare testuese.

**Shkaku:** -



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** APP të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e rasteve të konstatuara nga grupi i auditimit, si dhe verifikimin periodik dhe të shpeshtë të sigurisë së faqes Web, me qëllim minimizimin e kërcënimeve dhe rritjen e sigurisë së faqes Web.

**Titulli i gjetjes:** Mungesë në përcaktimin e lidhjes punonjës - user.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-punonjës i APP. Përdoruesit dhe të drejtat e tyre përcaktohen rast pas rasti, në varësi të burimeve njerëzore dhe të volumit të punës duke krijuar një risk potencial të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve, në kundërshtim me pikën 3.2.2.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

**Ndikimi/efekti:** Risk potencial të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulim të privilegjeve.

**Kriteri:** Plani i Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** APP të marrë masa për hartimin e një rregulloreje ku të përcaktohet qartë lidhja ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si user i sistemit me qëllim uljen e riskut të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve.

**Titulli i gjetjes:** Mungesë kontrolli në hapjen e user-ave.

**Situata:** Agjencia e Prokurimit Publik ka lejuar Autoritetet Kontraktore nëpërmjet një llogarie administratori të hapë llogari të tjera sipas nevojave të institucionit për të aksesuar në sistemin e APP. Nga auditimi u konstatua se hapja e këtyre përdoruesve mbetet pothuajse e pamonitoruar, pasi vetë APP nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre.

**Ndikimi/efekti:** Humbje e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorim i tyre.

**Kriteri:** Kontrolli i brendshëm.

**Shkaku:** -

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Në vazhdimësi APP të marrë masa për verifikimin e përdoruesve të hapur nga llogaritë administratore të Autoriteteve Kontraktore, duke ulur riskun e humbjes së konfidencialitetit të të dhënave si dhe keqpërdorimit të tyre.

**Pika 5. “ Të ndryshme të dala gjatë auditimit”**

*Buletini i njoftimeve, publikuar në Web.*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Veprimtaria e Agjencisë së Prokurimit Publik bazohet në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr.10 309, datë 22.07.2010, ligjin nr. 22/2012, ligjin nr. 131/2012, ligjin nr. 182/2014 dhe ligjin nr. 47/2017 “Për prokurimin publik”.

Agjencia e Prokurimit Publik:

- a) paraqet në Këshillin e Ministrave propozime për rregullat e prokurimit;
- b) nxit dhe organizon kualifikimin e punonjësve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të përfshirë në veprimtaritë e prokurimit publik;
- c) harton dhe nxjerr Buletinin e Njoftimeve Publike, siç është përkrahur në rregullat e prokurimit. Agjencia e Prokurimit Publik shpall në Buletinin e Njoftimeve Publike listën e operatorëve ekonomikë të përjashtuar, në përputhje me nenin 45 të këtij ligji;
- ç) harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik;
- d) në përputhje me kërkesën, jep këshilla dhe asistencë teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi;
- dh) paraqet një raport vjetor në Këshillin e Ministrave, për funksionimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik;
- e) bashkëpunon me institucionet ndërkombëtare dhe me ente të tjera të huaja për çështje që lidhen me sistemin e prokurimit publik;
- ë) planifikon dhe bashkërendon ndihmën teknike të huaj për Shqipërinë në fushën e prokurimit publik;
- f) nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike kombëtare, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve;
- g) verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron mbarëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.
- i) në rast shkeljesh të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjopa sipas nenit 72 të këtij ligji ose i propozon drejtuesit të autoritetit kontraktor apo organeve më të larta masa disiplinore për personat e autoriteteve kontraktore, që i kanë kryer këto shkelje;
- k) harton dhe përshtat rregulloret e saj të brendshme.
- l) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).

Bazuar në përcaktimin që i bën ligji kompetencave të APP, Buletini duhet të publikojë njoftime, rregullore e procedura që lidhen me Prokurimin publik, Konkensionet/PPP si, Ankandet dhe njoftime të tjera që lidhen me veprimtarinë e institucionit.

Përmbajtja e Buletinit që publikon në faqen zyrtare web çdo 5 ditë përmban njoftime të ndryshme të cilat bazohen në VKM nr. 176, datë 29.03.2006. “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”. Në këtë vendim, në pikën 3 të tij, renditen elementët që duhet të përmbajë çdo numër buletini, ndarë në krerët si më poshtë:

- Kreu I “Buletini i Prokurimit Publik”
- Kreu II “Buletini i Departamentit të Administratës Publike”
- Kreu III “Buletini i Ankandit”
- Kreu IV “Buletini i ofertave të qirave”
- Kreu V “Buletini i Shkollave të Larta”
- Kreu VI “Njoftime të tjera”

Në opinion të grupit të auditimit, njoftimet në kreun II dhe V, që lidhen me aktivitetin e Departamentit të Administratës Publike, Shkollat e Larta etj, të cilat aktualisht janë pjesë e Buletinit, por jashtë qëllimit ligjor të APP, mund të publikohen në kanale të tjera komunikimi që lidhen me vetë insitucionet.

**Nga auditimi rezulton se** në kategorinë “Njoftime të tjera” të Buletinit, janë përfshirë dhe njoftime për vende të lira pune të institucioneve të ndryshme.

Këto njoftime, të cilat janë jashtë qëllimit për të cilin është krijuar Agjencia e Prokurimit Publik, përbëjnë jo vetëm një kosto të tepërt për APP në materiale dhe burime njerëzore, por njëkohësisht nuk orientojnë saktë të interesuarit për këto vende pune. VKM nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike” e cila përcakton përmbajtjen e Buletinit është në kundërshtim me objektin e aktivitetit përcaktuar me ligj.

Nga sa më sipër, grupi i auditimit e konsideron të domosdoshëm ndryshimin e VKM nr. 176, datë 29.03.2006 apo përshtatjen e saj në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, ligjin nr.10 309, datë 22.07.2010, ligjin nr. 22/2012, ligjin nr. 131/2012, ligjin nr. 182/2014 dhe ligjin nr. 47/2017 “Për prokurimin publik”.

*Në lidhje me këtë pikë nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi nr. 3, datë 08.10.2018, për të cilin nga ana e subjektit është observuar me anë të shkresës nr. 9168/1, datë 15.10.2018, në lidhje me:*

*I. Publikimin e njoftimeve në Buletin, kostot e këtyre publikimeve për APP, sqarojmë se grupi i auditimit i qwndron propozimit për ndryshimin e VKM nr.176, datë 29.03.2006 “Për botimin e Buletinit të Njoftimeve publike”, për arsye të përmirësimit teknologjik te informimit që ka cdo insitucion pas 12 vjetësh që kur kjo VKM udhëzon publikimin e njoftimeve. Grupi i auditimit gjykon se ato njoftime që nuk lidhen me objektin e APP nuk mund të jenë kosto e saj, e për më tepër kur mungojnë njoftime për Konkensionet/Ankandet të cilat janë detyrim drejtperdrejt i APP.*

**Titulli i gjetjes:** Përmbajtja e Buletinit



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Situata:** Nga auditimi mbi përmbajtjen e Buletinit që publikon APP bazuar në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 rezulton se janë pjesë e tij dhe njoftimeve si Vende të Lira Pune, Shkollat e Larta dhe nga DAP, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e aktivitetit të saj përcaktuar në ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndërkohë që në VKM janë lënë jashtë publikimit njoftime që lidhen me Konkensionet/PPP.

Së pari publikimi i njoftimeve në kategoritë përmendur më sipër nuk orienton drejt të interesuarit dhe së dyti data e dorëzimit mund të ketë përfunduar përpara se të publikohet njoftimi pasi afati i publikimit të Buletinit është cdo 5 ditë.

**Ndikimi/efekti:** APP konsumon burime njerëzore dhe nuk orienton si duhet të interesuarit.

**Shkaku:** VKM nr 176 datë 29.03.2006 përcakton për Buletinin elementë më shumë se sa LIGJI i APP.

**Rëndësia:** E Lartë

**Rekomandimi:** KM dhe APP të konsiderojnë ndryshime në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve” duke garantuar që përmbajtja e Buletinit të jetë në përputhje me objektin e aktivitetit përcaktuar në Ligj dhe publikimet e kategorive që nuk janë në përputhje me objektin e APP të delegohen në institucione përgjegjëse.

**IV.1. Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

**Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.**

Grupi i auditimit mbështetur në Standartet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH " datë 27.11.2014 konstaton:

- Agjencia e Prokurimit Publik, ka marrë masa rregullative dhe organizative, për të garantuar disponibilitetin e sistemeve të informacionit, masat e marra për rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procedurave të prokurimit kanë rezultuar të suksesshme duke frenuar përdorimin e procedurës së prokurimit “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” gjatë vitit 2018 në krahasim me treguesit e vitit 2017.
- Ndryshimet e strukturave të TI në APP (dhe jo vetëm) mbartin riskun e dobësimit të Qeverisjes TI duke ulur rolin e tyre në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.
- Rezultatet e arritura janë të kompromentuara nga mungesa e Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit, duke mbartur riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së APP.

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**



**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përmbajtjen e Buletinit që publikon APP bazuar në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 rezulton se janë pjesë e tij dhe njoftimeve si Vende të Lira Pune, Shkollat e Larta dhe nga DAP, të cilat nuk janë në përputhje me objektin e aktivitetit të saj përcaktuar në ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ndërkohë që në VKM janë lënë jashtë publikimit njoftime që lidhen me Konkensionet/PPP.

Së pari publikimi i njoftimeve në kategoritë përmendur më sipër nuk orienton drejt të interesuarit dhe së dyti data e dorëzimit mund të ketë përfunduar përpara se të publikohet njoftimi pasi afati i publikimit të Buletinit është çdo 5 ditë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 57 të Raportit të Auditimit.)*

**1.1. Rekomandimi:** KM dhe APP të konsiderojnë ndryshime në VKM nr. 176 datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve” duke garantuar që përmbajtja e Buletinit të jetë në përputhje me objektin e aktivitetit përcaktuar në Ligj dhe publikimet e kategorive që nuk janë në përputhje me objektin e APP të delegohen në institucione përgjegjëse.

*Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Me ndryshimet e strukturave TI, APP-së i cenohet pjesa e rëndësishme e Qeverisjes TI. Roli i strukturës TI nuk duhet dhe nuk mund të zëvendësohet me struktura të tjera pasi struktura TI luan një rol të rëndësishëm në drejtim të mbledhjes së kërkesave, analizimit të nevojave, dhënies së zgjidhjeve dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje për problemet e TI.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 12 të Raportit të Auditimit.)*

**2.1 Rekomandimi:** I rekomandohet Këshillit të Ministrave ndryshimi i VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 pika 23, me përmirësimin si më poshtë;

**Është:** Strukturat përgjegjëse të AKSHI-t, Punonjësit aktualë të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit(NJTIK) në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, kalojnë tek AKSHI, brenda datës 31.12.2017 dhe do të trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil në rastin e mbylljes së ristrukturimit të institucionit , apo Kodit të Punës AKSHI vendos në dispozicion të institucioneve të përmendura në shkronjën “i” të pikës 6 personelin e mjaftueshëm dhe të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, për të mbajtur në funksion optimal sistemet të cilat nuk preken nga fushat e veprimit të këtij vendimi (kalimi i strukturave TI në varësi nga AKSHI-t)

**Të shtohet:** Në përbërje të strukturave të institucioneve dhe organeve të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, ngelet/krijohen strukturave TI në varësi direkt nga menaxhimi i lartë i institucioneve përkatëse me funksion kryerjen e detyrave të qeverisjes TI.

*Brenda vitit 2019*



## B. MASA ORGANIZATIVE:

### Pika 1. “Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK”

*a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK, vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik*

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka Strategji për Teknologjinë e Informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 12 të raportit të Auditimit.)*

**1.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të APP, duke marrë në konsideratë kohën, burimet e nevojshme si dhe rëndësinë e të dhënave që institucioni posedon dhe përpunon, të marrin masa për hartimin e Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi** App nuk ka menazhuar ndryshimin e strukturave të burimeve njerëzore të strukturave TI.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 12 të raportit të Auditimit.)*

**2.1 Rekomandimi:** APP në të ardhmen të marrë masa për rishikimin e bazës rregulative të strukturave TI në APP në përputhje me çdo ndryshim strukturor të kryer.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi u konstatua se APP nuk ka krijuar facilitetet e nevojshme për vënien në dispozicion tek të gjithë punonjësit përgjegjës për sigurinë e informacionit, udhëzimet mbi sigurinë e informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 16 të raportit të Auditimit.)*

**3.1 Rekomandimi:** APP të marrë masa për zhvillimin e mjeteve të komunikimit të brendshëm për krijimin e faciliteteve të nevojshme të gjithë punonjësve përgjegjës, të udhëzimeve, planeve mbi sigurinë e informacionit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Autoritetet Kontraktore të APP, gjatë vitit 2017 kanë përdorur në një shkallë të lartë procedurën me negociim pa shpallje paraprake e cila zë 31.8% të numrit total të procedurave të prokurimit, të zhvilluara apo 8.3% të vlerës totale.

Konstatohet se në 67% e rasteve të përdorimit të kësaj procedure janë për mbulimin e nevojave të fillim vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Përdorimi i kësaj metode për të “mbuluar nevojat” e fillimit të vitit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve mbart risqet: keqplanifikimet e nevojave dhe shmangien e konkurrencës, me pasojë efektivitet shumë të ulët të prokurimit.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

Nga analiza krahasimore e përdorimit të procedurës “Me Negocim pa Shpallje Paraprake” nga Autoritetet Kontraktore gjatë tremujoreve të parë të viteve 2017 dhe 2018 tregojnë se megjithë uljen e fondit të përdorur me këtë procedurë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 niveli i efektivitetit të prokurimit mbetet i ulët.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 17 të raportit të Auditimit.)*

**4.1 Rekomandimi:** APP duke vazhduar punën e nisur në fund të vitit 2017, të marrë masa për përmirësimin e legjislacionit në fuqi me qëllim rritjen e efektivitetit të procedurës “Me Negocim pa Shpallje Paraprake”.

***Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Sistemi i prokurimit publik nuk ka filtrat e nevojshëm për mos lejimin e hedhjes së të dhënave gabim, apo mos fillimin e procedurës së prokurimit pa pasur fondin limit të përcaktuar në 14 raste rezultojnë se fondi i prokuruar (609,887,131 lekë) është më i madh se fondi limit (395,611,677 lekë) në vlerën -214,275,454 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 22-25 të raportit të Auditimit.)*

**5.1 Rekomandimi:** APP të marri masat e nevojshme për vendosjen në bazën e të dhënave të sistemit të prokurimit publik të filtrave të nevojshëm si dhe kontrolleve në input e të dhënave.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Procedurat e Prokurimit të shpallura kanë një shkallë të lartë prej 19% të anulimit (vlerës së fondit), duke treguar se puna e AK për përgatitjen e procedurave (përcaktimi i nevojave, studimi i tregut, hartimi i dokumentacionit në përputhje me legjislacionin) është e pa mjaftueshme dhe ka nevojë për përmirësim. Mos kryerja në kohë e investimeve duhet të kosiderohet jo vetëm si mos efektivitet në përdorimin e burimeve por impakt negativ me ka një spektër me të gjërë.

Nga analiza e procedurave të publikuara dhe të kryera me përfundim lidhje kontrate rezultojnë me risk 393 procedura me fond të prokuruar 8,767,669,428 lekë të cilat janë lidhur në muajt janar-shkurt si rrjedhojë e kohës së limituar në përgatitjen e dokumentacionit përkatës si dhe zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Paraqesin risk të lartë në lidhje me kohën e nevojshme për zbatimin e kontratave 435 procedura me fond 8,248,475,384 të cilat janë lidhur në muajin dhjetor 2017.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 22-25 të raportit të Auditimit.)*

**6.1 Rekomandimi:** APP të kryejë monitorimin dhe vlerësimin e situatës dhe të ndërmarrë përmirësimet e nevojshme në aktet rregullatore të procedurave të prokurimit për minimizimin e fenomeneve të cilat ulin performancën e prokurimit publik.

***Brenda vitit 2019 dhe në vijimësi***



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

***b. Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se:

- a. Përshkrimet e punës ku janë transferuar specialistët TI, nuk kanë ndryshuar shumë nga detyrat e mëparshme që po të njëjtët specialist kryenin.
- b. Në asnjë përshkrim pune nuk janë pasqyruar përgjegjësitë që lidhen me sigurinë në rregulloren e sigurisë paragrafi 5.1 “Rregullorja për organizimin e punës në APP”.
- c. Nuk rezultojnë të dokumentuara detyrat e përkohshme që kryejnë punonjësit deri në plotësimin e strukturës me specialist TI nga AKSHI.
- d. Detyra të përcaktuara në rregulloren e sigurisë si psh “**Administrator**” nuk adresohen në përputhje me përshkrimin e punës së punonjësve.
- e. Specialistët e TIK jo vetëm që nuk kanë kryer trajnime për periudhën object auditimi, por APP nuk ka marrë as përgjigje për ndonjë pjesëmarrje në të ardhmen nga insitucionet të cilave ju është drejtuar AKSHI-t dhe AKSK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 33 të raportit të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** APP të rishikojë përshkrimin e punës për çdo punonjës, për të përcaktuar sa më afër detyrave reale që specialistët e saj kryejnë ku të përcaktojë dhe detyrat funksionale që dhe të identifikojë detyrat e përkohshme, të cilat kryhen aktualisht nga specialistët e saj por që do të transferohen tek AKSHI në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit”.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se pozicioni i kërkuar për “Oficer Sigurie” nga APP nuk është miratuar në strukturën e saj gjatë periudhës objekt auditimi. APP nuk disponon as ndonjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë kërkesë e cila ka qenë një rekomandim nga KLSH në auditimin e mëprashëm.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 35 të raportit të Auditimit)*

**8.1. Rekomandimi:** APP nën përgjegjësinë që i jep ligji nr 9887 datë 10.08.2008 ndryshuar “Për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave të prokurimit publik”, të rikërkojë ndryshim të strukturës për pozicionin Oficer Sigurie i cili edhe pse formimin mund ta ketë të bazuar në Teknologjinë e Informacionit nuk është pjesë e strukturës së TIK, por raportimi i tij duhet jetë në nivelin më të lartë drejtues të APP bazuar në standartet ndërkombëtare, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet pavarësia dhe mund të shmangët konflikti i interesit, për arsye të ushtrimit të kompetencave të tij.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se numri prej 4 specialistësh në teknologjinë e informacionit për vitin 2017 ka qenë shumë i vogël, për ofrimin e asistencës teknike për probleme të ndryshme që mund të hasin autoritetet kontraktore si dhe garantimin e disponibilitetit të sistemit të prokurimit që është 24 orë në 7 ditë të javës.



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 36 të raportit të Auditimit.)*

**9.1. Rekomandimi:** APP të identifikojë të gjitha detyrat lidhur me asistencën teknike që janë realizuar nga specialistët e saj, që të parashikojë saktë delegimin e tyre tek specialistët e TIK që do të vihen në dispozicion nëpërmjet AKSHI-t.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**Pika 2. “Auditimi i projekteve e investimeve të teknologjisë së informacionit”**

***a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK***

**10. Gjetje nga auditimi:** Deri në momentin e kryerjes së auditimit, procedura e prokurimit “Pajisje elektronike për sistemin TI”, e cila pritet të finalizohet nga AKSHI, nuk ka përfunduar ende, duke vënë në rrezik ecurinë normale të punës, kryesisht lidhur me procesin e backup-it (mungesa e Tape-ve). Grupi i auditimit e vlerëson këtë situatë me risk të lartë, pasi procesi i backup-t është një proces mjaft i rëndësishëm për ruajtjen periodike të të dhënave. Arsyet që kanë ndikuar në këtë vonesë, në opinionin tonë, krahas vonesave në kryerjen e procedurës nga AKSHI, të cilat grupi i auditimit për efekt të objektit të auditimit nuk mund t’i auditojë, lidhen me kërkesën e vonuar të APP kundrejt AKSHI-t. Gjithashtu, edhe procedurat e tjera të trajtuara nga grupi i auditimit, janë zhvilluar në muajin dhjetor, duke rrezikuar humbjen e fondeve të vitin ushtrimor në rast anulimi/shtyrjeje të përkohshme të procedurave.

Grupi i auditimit shpreh opinionin se procedurat e prokurimit, sidomos ato që lidhen me procese të rëndësishme të ecurisë së punës, duhet të nisin sa më shpejtë gjatë vitit, duke mos rrezikuar gjendjen në situata të paparashikuara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 40 të raportit të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Në vazhdimësi APP të marrë masa që procedurat e prokurimit, sidomos ato që lidhen me procese të rëndësishme të ecurisë së punës, të nisin sa më shpejtë gjatë vitit, duke mos rrezikuar gjendjen në situata të paparashikuara.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nisur nga eksperiencia e grupit të auditimit si dhe gabimit të konstauruar në procedurën “Blerje pajisje kompjuterike, UPS dhe fotokopje 2017”, për arsye të ndryshme, ka mjaft raste ku ana shkresore nuk përputhet me atë elektronike. Gjithashtu mbajtja e dokumentave shkresor, pa i bërë pjesë të dosjes elektronike të procedurave të prokurimit, rrit riskun e tjetërsimit të tyre me kalimin e kohës. Grupi i auditimit vlerëson se është e nevojshme përditësimi i faqes së APP, duke krijuar mundësinë e hedhjes apo ngarkimit të të gjithë dokumentacionit të procedurave të prokurimit, duke rritur besueshmërinë e gjurmës së auditimit të këtyre procedurave.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 38-41 të raportit të Auditimit)*



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**11.1. Rekomandimi:** APP të shqyrtojë mundësinë e shtimit të opsionit të hedhjes së të gjithë dokumentacionit të tenderit me qëllim rritjen e besueshmërisë në procedurat e prokurimit duke e plotësuar elektronikisht të gjithë gjurmën e auditimit.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**Pika 3. “Auditimi i sigurisë së informacionit”**

***a. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi risqet në TIK, rezultoi se:

-Risqet e identifikuara për vitin 2017 si dhe prioriteti dhe probabiliteti janë të njëjta me 3 risqet e identifikuara në vitin 2018, në mospërputhje me nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Në të dy regjistrat e viteve 2017 dhe 2018 nuk rezulton që gjatë vitit të ketë patur përditësime me risqe të reja të identifikuara gjatë periudhës.

-Nuk janë analizuar dhe dokumentuar si pjesë e regjistrat të riskut hapat që duhen ndërmarrë nga specialistët e TIK, për minimizimin e çdo risku të identifikuar për teknologjinë e informacionit.

- Nuk janë identifikuar risqe në lidhje me: *sigurinë, disponibilitetin dhe integritetin e sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nëpërmjet sistemit të prokurimit publik* si dhe palët e treta që janë kontraktuar për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit të prokurimit elektronik dhe fizik.

-Nuk janë identifikuar risqe të mundshme që lidhen me plotësimin e saktë të të dhënave për procedurat e parashikuara nga autoritet kontraktore, për tu zhvilluar në vitin kalendarik, proces ky i cili është informatizuar dhe ka përfunduar fazën e testimit.

-Nuk janë identifikuar risqet në burimet njerëzore të TIK, të cilat duhen adresuar për të siguruar mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të prokurimit.

-Ndarja ose transferimi i risqeve së bashku me asetet tek AKSHI, dhe për cilat risqe ndjekja dhe minimizimi i tyre do të administrohen nga APP.

-Nuk janë analizuar dhe identifikuar mbivendosjet ligjore, si dhe hapat që do të ndërmerren për minimizimin e problemeve që mund të ndodhin në sistemin e prokurimit si dhe përgjegjësitë ndërmjet e AKSHI-t dhe APP.

-Nuk janë identifikuar rrisqe që lidhen me hapa të procedurës së prokurimit që janë ende të painformatizuar për përmirësim të sistemit të prokurimit si prsh, të dhënat që lidhen me nënkontraktimin të cilin autoritet kontraktore aktualisht e administrojnë në letër.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 45 të raportit të Auditimit)*



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**12.1. Rekomandimi:** APP me transferimin e asetëve dhe burimeve njerëzore të AKSHI, në bashkëpunim me këtë të fundit të analizojë dhe të konsiderojë risqet që lidhen me Teknologjinë duke bërë një ndarje sa më reale midis atyre që do të administrojë vetë dhe atyre që për shkak të teknike i delegohen AKSHI-t. Të dokumentohen përgjegjësit dhe hapat që duhen ndjekur për çdo risk të identifikuar. APP të përditësojë regjistrin me risqe të reja të identifikuara gjatë periudhës dhe të mbajë në monitorim të vazhdueshëm ecurinë e risqeve, ku theksi duhet të jetë në garantimin e sigurisë, disponibilitetit dhe integritetit të sistemit dhe të dhënave që gjenerohen nga sistemi i prokurimit publik.

*Brenda 6 muajit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se lista e kodeve CPV edhe pse është konfiguruar dhe plotësimi në sistem është bërë i detyrueshëm, në web nuk është publikuar, për t'i dhënë mundësi autoriteteve kontraktore që të studiojnë listën e kategorive, përpara plotësimit të saj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 46 të raportit të Auditimit)*

**13.1. Rekomandimi:** APP të marrë masa për Informimin e AK me listën e kodeve CPV që përcaktojnë saktë kategorinë e produktit. Njëkohësisht APP të bëjë ndryshimet e nevojshme në listën e kategorive të produktit duke hequr nga mundësia e zgjedhjes kodin 000000 si dhe të garantojë suportin për ndryshime apo shtime në listën e kategorive.

*Brenda 6 muajit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**Pika 4. “Auditimi i Aplikacioneve”.**

***a. Verifikimi i shkallës së sigurisë së aplikacioneve***

**14. Gjetje nga auditimi:** Portali i APP nuk përdor një lidhje të sigurt (*connection security*) HTTPS (*HyperText Transfer Protocol Secure*) (*Not secure status*) që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm. Në mungesë të kësaj certifikate ekziston risku për humbjen e privatësisë, ndryshimit të informacionit që merret ose jepet me anë të këtij portali.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 48-49 të raportit të Auditimit)*

**14.1. Rekomandimi:** APP në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për mbarëvajtjen e faqes Web, të marrin masa për përmirësimin e faqes Web me elementët përkatës të sigurisë (*certifikatën e sigurisë*) së navigimit online për të rritur sigurinë dhe ndihmesën ndaj përdoruesve.

*Brenda 6 muajit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** APP disponon politika të shkruara mbi vazhdimësinë e punës (*business continuity*), si dhe politika të shkruara mbi rimëkëmbjet nga katastrofat (*disaster*



**KONTROLLI I LARTË I SHITETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

recovery). Nga auditimi u konstatua se APP nuk disponon dokumentacion për ngritjen e grupit të punës apo të testeve zhvilluara për funksionimin e këtyre dy politikave mjaft të rëndësishme për sistemin e APP, në kundërshtim me pikën 9.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017. Këto teste duhet të kryhen në mënyrë periodike dhe me theks të lartë sa herë të ketë ndryshime thelbësore, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se sistemi do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur. Për këtë arsye grupi i auditimit shprehet me rezervë mbi funksionimin apo jo të dy politikave të mësipërme mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjen nga katastrofat, në rast se do të jetë e nevojshme.

Gjithashtu plani i fundit i rikuperimit nga katastrofa i vënë në dispozicion të grupit të auditimit është me datë 07.04.2017, në kundërshtim me pikën nr. 9.3 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017, sipas së cilës këto plane duhet të rishikohen të paktën një herë në vit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 48-49 të raportit të Auditimit)*

**15.1. Rekomandimi:** Nga APP të merren masat e nevojshme për testimin e politikave mbi vazhdimësinë e punës (business continuity) dhe mbi rimëkëmbjen nga katastrofat (disaster recovery) sa herë që ato azhurnohen apo ndryshojnë, me qëllim dhënien e sigurisë së arsyeshme se do të funksionojë në të gjitha situatat hipotetike, dhe se burimet njerëzore janë të mirënjohura me zbatimin e hapave që duhen ndjekur.

Nga APP të merren masat e nevojshme për përditësimin e planeve të rimëkëmbjes nga katastrofat dhe vazhdimësisë së punës të paktën një herë në vit me qëllim për të qenë gjithnjë në koherencë me ndryshimet, në përputhje me Planin e Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit e testoi faqen e APP në disa “free page security test”, nga ku rezultuan mjaft raste ku shfaqeshin “malware” si dhe pika të dobëta dhe jo të sigurta të faqes. Për arsye sigurie dhe konfidencialiteti, grupi i auditimit nuk do ti bëjë pjesë të materialit, por do ti komunikojë ato me stafin përgjegjës të APP.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 49-50 të raportit të Auditimit)*

**16.1. Rekomandimi:** APP të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e rasteve të konstatuara nga grupi i auditimit, si dhe verifikimin periodik dhe të shpeshtë të sigurisë së faqes Web, me qëllim minimizimin e kërcënimeve dhe rritjen e sigurisë së faqes Web.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-punonjës i APP. Përdoruesit dhe të drejtat e tyre përcaktohen rast pas rasti, në varësi të burimeve njerëzore dhe të volumit të punës duke krijuar një risk potencial të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

akumulimin e privilegjeve, në kundërshtim me pikën 3.2.2.1 të Planit të Sigurisë së Rishikuar me nr. 8904/7 prot, datë 10.04.2017.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 54 të raportit të Auditimit)*

**17.1. Rekomandimi:** APP të marrë masa për hartimin e një rregulloreje ku të përcaktohet qartë lidhja ndërmjet pozicionit të punës dhe të drejtave që ky pozicion duhet të ketë si user i sistemit me qëllim uljen e riskut të akordimit subjektiv të të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***

**18. Gjetje nga auditimi:** Agjencia e Prokurimit Publik ka lejuar Autoritetet Kontraktore nëpërmjet një llogarie administratori të hapë llogari të tjera sipas nevojave të institucionit për të aksesuar në sistemin e APP. Nga auditimi u konstatua se hapja e këtyre llogarive mbetet pothuajse e pamonitoruar, pasi vetë APP nuk kryen monitorime që lidhen me këtë veprim, duke rritur riskun e krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr. 57 të raportit të Auditimit)*

**18.1. Rekomandimi:** Në vazhdimësi APP të marrë masa për verifikimin e llogarive të përdoruesve të hapur nga llogaritë administratore të Autoriteteve Kontraktore, për të ulur riskun e humbjes së konfidencialitetit të të dhënave si dhe keqpërdorimit të tyre.

***Brenda 3 mujorit të parë të vitit 2019 dhe në vijimësi***



## **V. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES:**

**Pjesë përbërëse e këtij Raport Auditimi është dhe dokumentacioni i mbajtur si më poshtë:**

- Akt Konstatimi nr. 1, datë 08.10.2018 “Vlerësimi i burimeve njerëzore në strukturat TIK”, protokolluar në APP, me nr. 8399/1, datë 08.10.2018;
- Akt Konstatimi nr. 2, datë 08.10.2018 “Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK”, protokolluar në APP, me nr. 8399/2, datë 08.10.2018;
- Akt Konstatimi nr. 3, datë 08.10.2018 “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, protokolluar në APP, me nr. 8399/3, datë 08.10.2018;
- Akt Konstatimi nr. 4, datë 08.10.2018 “Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime në TIK”, protokolluar në APP, me nr. 8399/4, datë 08.10.2018;
- Akt Konstatimi nr. 5, datë 08.10.2018 “Verifikim i shkallës së sigurisë së aplikacioneve”, protokolluar në APP, me nr. 8399/5, datë 08.10.2018;
- Akt Konstatimi nr. 6, datë 08.10.2018 “Verifikim i Strategjisë, politikave dhe procedurave TIK, vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik”, protokolluar në APP, me nr. 8399/6, datë 08.10.2018
- Akt Konstatimi nr. 7, datë 08.10.2018 “Vlerësimi i performancës së procedurave të prokurimit publik”, protokolluar në APP, me nr. 8399/7, datë 08.10.2018;

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **Grupi i Auditimit**

- 1. Kozma KONDAKÇIU, Përgjegjës i Grupit të Auditimit**
- 2. Elira CUKALLA, Audituese**
- 3. Bledi DERVISHAJ, Auditues**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**Kozma KONDAKÇIU**



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT USHTRUAR**  
**NË AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK (APP).**

**Tabela e Shkurtimeve**

<b>Nr</b>	<b>Shkurtimi</b>	<b>Emërtimi i Plotë</b>
1	<b>KLSH</b>	<b>K</b> ontrolli i <b>L</b> artë i <b>S</b> htetit
2	<b>APP</b>	Agjencia e <b>P</b> rokurimit <b>P</b> ublik
3	<b>AKSHI</b>	Agjencia <b>K</b> ombëtare e <b>S</b> hoqërisë së <b>I</b> nformacionit
4	<b>ARK</b>	Autoriteti <b>R</b> regullator <b>K</b> oordinues
5	<b>BCP</b>	<b>B</b> usiness <b>C</b> ontinuity <b>P</b> lan
6	<b>DR</b>	<b>D</b> isaster <b>R</b> ecovery
7	<b>DRC</b>	<b>D</b> isaster <b>R</b> ecovery <b>C</b> enter
8	<b>DRP</b>	<b>D</b> isaster <b>R</b> ecovery <b>P</b> lan
9	<b>KM</b>	<b>K</b> ëshilli i <b>M</b> inistrave
10	<b>MF</b>	<b>M</b> inistria e <b>F</b> inancave
11	<b>LPP</b>	<b>L</b> egjislacioni i <b>P</b> rokurimit <b>P</b> ublik
12	<b>MNSH</b>	<b>M</b> arrëveshjeve të <b>N</b> ivelit të <b>S</b> hërbimit
13	<b>SLA</b>	<b>S</b> ervice- <b>L</b> evel <b>A</b> greement
14	<b>TI (IT)</b>	<b>T</b> eknologjia e <b>I</b> nformacionit
15	<b>TIK</b>	<b>T</b> eknologjia e <b>I</b> nformacionit dhe <b>K</b> omunikimit
16	<b>VKM</b>	<b>V</b> endim i <b>K</b> ëshillit të <b>M</b> inistrave
17	<b>WS</b>	<b>W</b> eb- <b>S</b> ervices
18	<b>DAP</b>	<b>D</b> epartamenti i <b>A</b> ministratës <b>P</b> ublike
19	<b>AKSK</b>	Agjencia <b>K</b> ombëtare për <b>S</b> igurinë <b>K</b> ompjuterike